Xhafer Durmishi

SKENDER

VEPRA
14

PA TRAZIME

1. TMERRËSISHT I FRIKËSUAR NGA FUSHATA E TËRBUAR
2. ORGANIZATAT POLITIKE SHQIPTARE NË EVROPË 1979-1985
-1. Lidhja Sabri Novosella- Jusuf Gërvalla
-2. LNÇKVSHJ dhe OMLK (Jusuf Gërvalla- Kadri Zeka)
-3. Tezat e OMLK-së rreth Fronit Popullor për Republikën e Kosovës
-4. LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, bisedimet në Ankara
-5. Prishja e Sabri Novosellës me Xhafer Shatrin
-6. "Zëri i Kosovës", Suedi
-7. "Zëri i Kosovës", organ i LNÇKVSHJ-së
-8. "Zëri i Kosovës", organ i Grupit Komunist të Riza Salihut
-9. "Zëri i Kosovës", organ i LNÇKVSHJ-së, i drejtuar nga Jusuf Gërvalla
-10. "Zëri i Kosovës", organ i LRSHJ-së
-11. "Zëri i Kosovës", organ i Grupit Revolucionar të Xhafer Shatrit
-12. Kronologji e shkurtër ngjarjesh në jetën e organizatave në mërgim

3. PËR MUA NUK LUAN AS ROLIN MË TË VOGËL
-1. Letër për Premton dhe Donika Gërvallën, 12 maj 2007
-2. Letër nga Donika Gërvalla, 12 maj 2007
-3. Letër për Donika Gërvallën, 13 maj 2007
-4. Vazhdim i letrës së 13 majit 2007

4. PA TRAZIME
Korrespondenca ime me Ramadan Pllanën

5. JUSUF GËRVALLA - BIBLIOGRAFI AKTUALE

6. I MADHI ZOT TË RUAJTË NGA DJALLI I MALLKUAR DHE NGA DJAJT-NJERI
Letërkëmbim me Shefqet Jasharin

1. TMERRËSISHT I FRIKËSUAR NGA FUSHATA E TËRBUAR

Sabri Novosella: *"**Fushatë e tërbuar** filloi kundër Xhafer Durmishit. Posa u duk se u krye puna me të, filloi një fushatë edhe më e tërbuar kundër Sabri Novosellës. Kështu u arritë përçarja e plotë e LRSHJ-së dhe u krijuan dy krahë të saj. Filloi të dalë edhe një organ me emrin Zëri i Kosovës me adresë në Suedi. Këtë organ e udhëhiqte Xhafer Durmishi. Xhafer Durmishi **i frikësuar tmerrësisht** se mos po akuzohet si reaksionar, e kur të jepej epiteti reaksionar nënkuptohej edhe se je kundër PPSH, kundër Shqipërisë e tradhtar, kështu që Xhafer Durmishi në këtë organ u bë më Lenin se Lenini e më Stalin se Stalini, për të cilën gjë e jepte bekimin diplomacia shqiptare në Stockholm për çdo numër të organit. Për këtë punë intervenova unë dhe e ndala botimin e "Zëri i Kosovës", me adresë në Suedi*." (Si e krijuam Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, Zëri, 28 mars - 4 prill 1992)

Sabri Novosella: *"Xhafer Shatri i nxitur nga njerëzit e Engjëll Kolonecit e botoi një numër të jashtëzakonshëm kundër Sabriut e disa shokëve të tij në Gjermani. Edhe një shok i imi, nga frika se mos po e akuzojnë si njeri kundër Shqipërisë, u bë më marksist se vetë Marksi. Iu përgjigj Xhafer Shatrit në të njëjtën mënyrë me një numër të "Zërit të Kosovës" që filloi të dalë nga shokët e mi."* (REZISTENCA KOSOVARE MES DY ZJARRESH, Prishtinë 2010, f. 171)

Sabri Maxhuni-Novosella: "*Xhafer Durmishit, bashkveprimtarit dhe bashkpunëtorit më të afërt të Heroit Jusuf Gërvalla në Gjermani. Me respekt. Autori. Shkurt 2012; fjalë të shkruara me dorë si dedikim të dhuratës-librit "Rezistenca Kosovare mes dy zjarresh", Prishtinë 2012)*

2. Organizatat politike shqiptare në Evropë 1979-1985


ZËRI I KOSOVËS
Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare në Jugosllavi
Nr. 1 Nëntor 1981

Nga tri fotografi të botuara në "Zëri", të Sabri Novosellës, Metush Krasniqit dhe Jusuf Gërvallës, fitohet përshtypja se LNÇKVSHJ është udhëhequr nga treshi Sabri-Metush-Jusuf.

Jusuf Gërvalla nuk e ka njohur Metush Krasniqin në cilësinë e kryetarit të LNÇKVSHJ. Në qoftë se shërbehemi, për hir të qartësisë, me gjeometri, nuk ka ekzistuar trekëndëshi Sabri-Metush-Jusuf, dhe as segmenti Metush-Jusuf, pra lidhja e drejtpërdrejt Metush Krasniqi-Jusuf Gërvalla. Këtë nuk e pohon drejtpërdrejtë as Sabriu, por përpiqet ta parashtroj në mënyrë indirekte: "Për këtë Jusufi e njoftonte vazhdimit degën e LNÇKVSHJ në Turqi dhe Metush Krasniqin, kryetarin e Lëvizjes në Kosovë".

Jusuf Gërvalla, Metush Krasniqi dhe Sabri Novosella

Për të painformuarin citati i tillë duket i kthjellët dhe të lenë përshtypjen se lidhja e drejtpërdrejtë Metush-Jusuf ka ekzistuar. Për ata që formulimin e tillë e kuptojnë se lidhja ka ekzistuar, ky është një mashtrim. Për ata që e dinë këtë, e ky është një numër i vogël, Sabriu në frazën e vetë e ka gatuar mbrojtjen. Jusufi e njoftonte degën në Turqi (së pari pra-shënim i Xh. D.) dhe Metush Krasniqin, kryetarin e Lëvizjes në Kosovë (së dyti-shënim i Xh. D.). Del se të painformuarit, 99,9 % e lexuesve gënjehen, ndërsa për të informuarit është mburoja: Jusufi kishte lidhje me kryetarin Metush Krasniqi, por kjo lidhje ishte nëpërmjet Sabri Novosellës, i cili informohej së pari, e që ky pastaj e njoftonte kryetarin në radhë të dytë.

Jusuf Gërvalla nuk ka pas kurrë lidhje me Metush Krasniqin. Për këtë nuk ka asnjë dëshmi. Pasi që nuk ekziston asnjë letër, asnjë artikull, asnjë udhëzim me vlerë që ka qenë i njohur në Gjermani apo dikund tjetër, kjo duhet të merret si e pavërtetë. Ai që do ta nxjerrë Metush Krasniqin si kryetar të Lëvizjes, duhet të sjellë fakte.

Në një bisedë me Jusufin në verën e vitit '81 lidhur me udhëheqësinë e Lëvizjes, ai thotë: "Sabriu është kryetari i Lëvizjes".

Kaq për (jo)lidhjen Metush Krasniqi-Jusuf Gërvalla.

-1. Lidhja Sabri Novosella- Jusuf Gërvalla

Kjo lidhje ka ekzistuar, dhe si reale është më lehtë të ilustrohet me shembuj të shumtë. Ta shohim nga afër!

Sabri Novosella është ai i cili i ka ofruar anëtarësim Jusuf Gërvallës në LNÇKVSHJ. Jusufi pranon menjëherë me kënaqësi të madhe. Është meritë e Sabri Novosellës që duke e organizuar Jusuf Gërvallën në LNÇKVSHJ bëri që energjitë dhe

talenti i tij të derdhen e të kanalizohen menjëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë për çështjen e popullit shqiptarë në ish-Jugosllavi. Përveç Sabriut, Jusufi nuk ka njohur asnjë kuadër më të lart, as personalisht e as përmes ndonjë vepre. Natyrisht se Sabriu i ka fol Jusufit se ekziston Komiteti Qendror, Kryetari e gjëra të tjera.

Në dhjetor të vitit 1979 Sabriun për t'iu shmang ndjekjes e burgosjes, rrethanat e qesin në Turqi, ndërsa Jusufi, për arsye se Bardhosh Gërvalla punonte në Gjermani, shkoi në Gjermani. (Sabri Novosella dhe Jusuf Gërvalla e lëshuan Kosovën pothuaj njëkohësisht.)

Nënvizoni, jemi në mesin e dhjetorit 1979. Prej dhjetorit 1979 e deri në Mars 1981 Jusuf Gërvalla nuk ka asnjë lidhje të vetme me Sabri Novosellën, e lere më me Metush Krasniqin.

Si e udhëhoqën LNÇKVSHJ, Sabri Novosella e Metush Krasniqi prej dhjetorit 1979 e deri në mars 1981?

Po Jusuf Gërvalla?

Dalja e Jusufit jashtë si personalitet i njohur, bëri jehonë të madhe në Kosovë. Jehona ishte e ngjashme edhe në Gjermani. Ai u kontaktua nga Ibrahim Kelmendi i cili i kërkoi ndihmë për nxjerrjen e "Bashkimit" si organ i Frontit të Kuq Popullor. Ibrahim Kelmendi vetë e kishte nxjerrur vetëm një numër në verën e vitit 1979. Jusufi i ofroi çdo ndihmë Ibrahimit, duke i lënë në dispozicion artikuj të shumtë të cilët Ibrahimi i zgjidhte sipas dëshirës. Jusufi i nxori dhe përgatiti 3 numra të "Bashkimit", nga gjithsejtë katër sa dolën. Vetëm pas dy muajsh, në shkurt 1980, në Gjermani Jusufi nxori numrin e dytë të "Bashkimit". Në maj 1980 nxori numrin e tretë dhe në janar 1981 numrin e fundit të "Bashkimit".

Në fillim të vitit 1981 Jusufi e ndërpreu bashkëpunimin (në nivelin apo në cilësinë e redaktorit dhe ideologut të Frontit të Kuq) me Ibrahim Kelmendin, çka bëri që Bashkimi të mos dali më.

Në gusht 1980 doli numri i parë i "Lajmëtarit të lirisë". "Lajmëtari i lirisë" doli gjithsejtë në tre numra. Nr.1, gusht 1980, nr.2, tetor 1980, nr.3 janar 1981. Në një pyetje të drejtpërdrejtë Jusuf Gërvallës, pse e ke nxjerrë "Lajmëtarin e lirisë" pa e përzier atë me organizatën të cilës i takonte, Jusufi përgjigjet: "Unë nuk kamë pas lidhje me LNÇKVSHJ e me KQ, unë nuk kamë marrë asnjë direktivë për të nxjerrë ndonjë gazetë. Kam vepruar kështu që të mos mundet nesër të më thotë dikush se me kënd u more vesh që e nxore gazetën në emrin e LNÇKVSHJ-së".

Me penë dhe pushkë...

lajmëtari i lirisë

...për liri dhe bashkim me vendin amë, Shqipërinë socialiste!

Në kundërshtim të hapët me parimin e kombësisë dhe të vullnetit të popullsive vendëse, nga trungu i Shqipërisë u shkëputën krahina të tëra si Rrafshi i Dukagjinit, Kosova dhe tokat shqiptare në Maqedoni. Më tepër se gjysma e popullsisë së vendit dënohej të ndërronte zgjedhën e vjetër turke me një zgjedhë të re, atë të Serbisë dhe të Malit të Zi. ARBEN PUTO

viti I nr. 1 gusht 1980

Revista "Lajmëtari i lirisë"

Se ka dal një revistë me emrin "Lajmëtari i lirisë", Sabri Novosella e ka marrë vesh kah fundi i janarit 1981, d.m.th. pasi që janë nxjerrë të gjithë numrat dhe është ndërprerë dalja e tij.

Prej gjysmës së dhjetorit 1979 deri në gjysmën e janarit 1982, për këtë kohë sa Jusufi e Sabriu ishin njëkohësisht në mërgim, (25 muaj), kanë qenë në kontakt vetëm 10

muaj, d.m.th. 40% të kohës. Gjatë 25 muajve, përveç shumë trakteve, thirrjeve e artikujve, Jusufi herë pjesërisht e herë tërësisht punoi në nxjerrjen e 4 gazetave të ndryshme:

"Bashkimi": shkurt 1980, maj 1980, janar 1981,

"Lajmëtari i lirisë": gusht 1980, tetor 1980, janar 1981,

"Liria": nr. 3, maj 1981, nr. 4-5 korrik/gusht 1981,

"Zëri i Kosovës": nëntor 1981, janar 1982.

Pra prej 11 numrave të gazetave në të cilat pati dorë në nxjerrjen e tyre, vetëm 2 ishin të LNÇKVSHJ-së, të asaj organizate në të cilën ai ishte anëtar. Puna e tij për LNÇKVSHJ në mërgim nga aktiviteti i tij i gjithmbarshëm është vetëm 18,18%.

-2. LNÇKVSHJ dhe OMLK
Jusuf Gërvalla- Kadri Zeka

Në tetor 1980, dy muaj pas numrit të parë të "Lajmëtarit të lirisë" filloi dalja e revistës "Liria", organ i Marksistë-Leninistëve të Kosovës, që pati si rrjedhim edhe njohjen e Kadri Zekës me Jusuf Gërvallën. Ata duhet të jenë takuar në mes të shkurtit 1981. Por nuk është e vërtetë se ata filluan menjëherë bisedimet për bashkim. Pra fjalët e Sabriut, se menjëherë pas kontaktit të Jusufit me Kadriun filluan bisedimet për bashkim nuk janë të vërteta. Të pa vërteta janë edhe fjalët se ai e njoftonte LNÇKVSHJ-në në Turqi dhe kryetarin Metush Krasniqi. Është pikërisht mungesa e çfarëdo kontakti me LNÇKVSHJ-në, ajo që Jusuf Gërvalla nuk mund të bënte kurrfarë bisedimesh për bashkim. Por fakti që ai nuk mund të zhvillonte bisedime për bashkim nuk do të thotë se edhe nuk bënte punë për bashkim. Ai Kadri Zekës i ofroi ndihmë ashtu siç i kishte ndihmuar më parë Ibrahim Kelmendit. Ia la në dispozicion disa artikuj Kadri Zekës që të zgjedhë për numrin e tretë të "Lirisë", i cili doli në maj 1981, nën mbikëqyrjen teknike të Jusuf Gërvallës, i cili e radhiti dhe bëri të gjithë punën grafike e teknike për nxjerrjen e numrit të tretë. Jusufi gjithashtu organizoi dërgimin e këtij numri në Kosovë, duke e angazhuar për këtë punë shokun e vetë të ngushtë Haxhi Berishën nga Prapaqani, i cili ka futur me mijëra ekzemplarë të këtij numri në Kosovën e mbushur me forca të mëdha ushtarake e me atmosferën e orës policore.

Pranvera e vitit 1981 edhe në Evropën Perëndimore shkoi në shenjën e demonstratave të ndryshme e të një aktiviteti intensiv në përkrahje të demonstratave të Kosovës.

Tek në mars 1981, pas 15 muajve, Sabriu mori kontakt me Jusufin dhe menjëherë filloi të diskutoj me të për çështjen e nxjerrjes së "Zërit të Kosovës" si organ i LNÇKVSHJ-së.

Jusufi përgatiti teknikisht numrin 4-5 të "Lirisë", që doli në korrik 1981, dhe kontribuoi me artikuj. Edhe në këtë rast ai i dha detyrë Haxhi Berishës ta marrë përsipër futjen e këtij numri të dyfishtë në Kosovë. Kësaj radhe, prej anës së Kadri Zekës, ndihmës e shok i tij i rrugës u caktua Hasan Mala.

Çështja e bashkimit u aktualizua pas pushimit të demonstratave në mërgim, aty kah mesi i korrikut, kur numri 4-5 i "Lirisë" doli nga shtypi. Për një nevojë të bashkimit flitej e bëhej shumë fjalë. Në pritje të një bashkimi u vendos që të mos dilet me "Zërin e Kosovës" si organ i LNÇKVSHJ-së.

-3. Tezat e OMLK-së rreth Fronit Popullor për Republikën e Kosovës

Në shtator erdhën Tezat rreth Fronit Popullor për Republikën e Kosovës tek Jusufi. Jusufi ishte parimisht 100 % me tezat që shtroheshin. Ai i shtypi (radhiti) në

makinën e tij të shkrimit, i shumëzoi, i dërgoi një numër ekzemplarësh Kadri Zekës në Zvicër dhe vet i shpërndau në krejt rrethin e Shtutgartit. Bashkimi shikohej si një çështje dite, bisedat dukej se do të ishin vetëm formalitet me një procedurë shumë të shkurtë. Jusufi kurrë nuk do të përshkruante (radhiste) ato teza e t'i shpërndante sikur të mos pajtohej pikë për pikë me pikëpamjet e tyre.

Sabriu vazhdon: "Unë dhe Bardhoshi dolëm me qëndrimet e Organizatës që përfaqësonim: Të bashkohemi në një organizatë të vetme e cila mund të quhej Lëvizja për Republikën Shqiptare në Jugosllavi". Jusufi nuk ka përgatitur asgjë me shkrim për bisedimet e Stambollit të tetorit 1981, as Bardhoshit nuk i ka thënë asnjë fjalë për ndonjë farë Lëvizje për Republikë. Jusufi është pajtuar me germën dhe me frymën e tezave rreth Frontit për Republikë, ashtu si ai i ka lexuar ato dhe si ua ka përcjellë vetë të tjerëve. Tezat Jusufi i ka kuptuar në këtë formë:

- Formimi i partisë pararojë e cila do ta udhëheqë Frontin,
- Në parti do të hyjnë kuadrot më të formuar dhe më të dëshmuar.

Këtë lloj interpretimi e ka lënë të nënkuptohet Kadri Zeka gjatë kontakteve me Jusufin.

Në Stamboll, gjatë bisedimeve Kadriu jep sqarimin e vetë konkret e lakuriq se si duhet lexuar tezat:

- Jo parti pararojë e përbërë nga anëtarë të organizatave të tjera, por vetëm nga radhët e OMLK-së,
- vetëm anëtarët e OMLK-së janë marksistë, komunistë të formuar,
- në organizatat tjera të tillë nuk ka, prandaj të tjerët - në Front për Republikë, nën udhëheqjen e OMLK-së.

Bardhoshi u kthye aty më 13 tetor 1981, më saktësisht një ditë para se të hapej panairi i librit i Frankfurtit. Rrugës për në panair na u dha rasti së pari ta dëgjojmë Bardhin të tregoj për takimin e Stambollit. Bardhoshi tregoi se bisedimet në mes Sabri Novosellës e Kadri Zekës sa i përket bashkimit ishin të shkurta, dhe u ndërprenë shumë shpejt pasi Kadri Zeka tha se nuk ka ardhë të bisedoj për bashkim.

Thelbin e bisedimeve ai e tregoi me këto fjalë:

Sabri Novosella: Mund të fillojmë bisedimet për çka jemi mbledhur, bisedimet për bashkimin e organizatave në një të vetme?

Kadri Zeka: Ne jemi për krijimin e një fronti në bazë të këtyre tezave, i cili do të udhëhiqet nga OMLK!

SN: Ne kemi menduar se do të vish për çështjen e bashkimit të organizatave. Është çështja e këtyre bisedimeve për shkak të të cilave ne e kemi pezulluar nxjerrjen e "Zërit të Kosovës" qe disa muaj!

KZ: Unë nuk kam autorizime me bisedua për bashkimin më shumë se ajo që thash, e që është në teza!

SN: Atëherë pse ke ardhur?

KZ: Që të shihemi!

SN: Sa për t'u parë, mua më shumë më ka marrë malli për familjen time që nuk i kam pa qe dy vjetë.

Bardhi vazhdon, se, menjëherë pas mbylljes së bisedimeve u vendos që të fillohet me nxjerrjen e "Zërit të Kosovës", si organ i LNÇKVSHJ-së.

Jusufi u befasua nga mosrezultati i takimit, por edhe ishte i kënaqur që gjërat ishin qartësuar. Puna në nxjerrjen e "Zërit të Kosovës" qe e shpejtë dhe numri i parë doli pas njëzet ditësh, pra në fillim të nëntorit 1981.

Është paradoksale se si në bisedime qenka arsyetuar një qëndrim i përpiktë ndaj Republikës para dikujt që nuk ka ardhur as të zhvilloj bisedime, përveçse t'i komentoj e

sqaroj tezat rreth Frontit, e vetëm pas një ore të jepet direktiva për nxjerrjen e një gazete krejt në kundërshtim me atë që është mbrojtur në bisedime.
Në bisedimet e Stambollit roli përçarës i Bujar Hoxhës nuk ka qenë vendimtarë për rrjedhën e tyre.

-4. LNÇKVSHJ dhe PKMLSHJ, bisedimet në Ankara

Rruga ime në Turqi më 13 shkurt 1982, në radhë të parë ka qenë për ta informuar Sabriun për gjendjen e krijuar pas atentatit të 17 janarit dhe për të planifikuar punën e ardhshme.

Sabriu thotë se Shtabi i partisë me Abdullahun në krye, me gjithë gjërat qesharake e budallallëqet e tyre çmohet shumë nga diplomacia shqiptare e Bujar Hoxha. Ne do të bisedojmë me ta për bashkim. Mos ta nënçmojmë gjendjen, përkundër budallallëqeve që ke me i dëgjuar nga goja e tyre, mund të ndodhë që të vij deri te bashkimi.

Udhëheqja e Partisë përbëhej nga:

- Abdullah Prapashtica, Kryetar i Partisë Marksiste Leniniste Shqiptare në Jugosllavi (PKMLSHJ),
- gruaja e tij (e cila do të zgjidhej) kryetare e organizatës së gruas,
- Osman Osmani, sekretar,
- Faton Topalli, kryetar i organizatës së rinisë dhe nip i Abdullahut.

I vetmi prej tyre që din diçka, thotë Sabriu, është Fatoni, por si nip i Abdullahut nuk guxon të ketë mendime të pavarura.

Dhe me të vërtetë kur u takuam më vonë dukej se Fatoni ishte në aso pozite të keqe ku e kishte vu Abdullahu sa nuk di se a mund të gjendet ndonjë rast i ngjashëm tjetërkund. Vuajtja dhe mundimi i Fatonit qëndronte në atë se ai shpesh ngatërrohej dhe e kishte vështirë se si ta thirrte Abdullahun; shoku Kryetar apo dajë.

Thelbi i aktivitetit të partisë në gjithë "modestinë" e vetë ishte ky:

- Partia është autore e kërkesës Kosova Republikë dhe organizuese e demonstratave të vitit 1981,
- Abdullahu, në cilësinë e inspektorit të sigurimit shtetëror, ka pas mundësinë ta studioi aktin e Adem Demës-Demaçit. Për këtë arsye Adem Dema-Demaçi i takon PKMLSHJ-së, ai është ideologu i saj.
- Kriteri kryesor për zgjerimin e radhëve të partisë janë lidhjet familjare,
- Partia ka nxjerrë organin e vetë "Revolucioni", në të cilin Kryetari i partisë dhe sekretari i saj shpallen heronj të popullit, si dhe organin e rinisë "Atdheu",
- Partia i ka shkruar KQ të LKJ-së dhe e ka thirrë në bisedime nga pozita të barabarta,

Prandaj, vazhdohet me stilin e "modestisë",

- çdo gjë e mirë nga demonstratat e vitit 1981 janë vepër e popullit, ndërsa për pasojat merr përgjegjësinë partia,
- të gjithë ata që kanë luftuar për bashkim kombëtar janë njerëz të kompromet uar nga pikëpamja e Kosovës Republikë, dhe si të tillë duhet të tërhiqen mënjan ose t'i vihen në dispozicion politikës e shtabit të partisë, i cili ka dalë jashtë t'i bashkoi organizatat në PKMLSHJ.

Ndaj budallallëqeve të këtyre kalorësve të situatave, unë reagova ashtu siç ishte e natyrshme për të reaguar. Përkundër të gjithave ne do të duhej të bisedonim me ta.
Pas tri ditë bisedash në Adapazar, në mbrëmjen e 16 shkurtit u nisëm me Sabriun për në Ankara, atje ku ishte vendosur udhëheqja e PKMLSHJ-së. Së pari në Ankara, në paraditën e 17 shkurtit, takuam Bujar Hoxhën dhe biseduam për gjëra të përgjithshme. Ai e dinte

se ne do të bisedonim për bashkimin. Ai shtroi një pyetje të drejtpërdrejtë: Pse unë isha kundër asaj që organizata e krijuar të quhet parti, dhe shtoi më pas: "Bashkohuni!"

Ndërhyrja e tij kishte një peshë. Por kryesorja ishte ajo që ne (unë e Sabri Novosella) nuk ishim kundër bashkimit, ndërsa "motivi kryesor" i udhëheqjes së partisë për dalje jashtë, thuhej se ishte pikërisht që t'i bashkoj organizatat. D.m.th. ekzistonte baza për fillimin e bisedimeve pa kushte, me mundësi për marrje vendimesh, pa u fshehur pas mungesës së autorizimeve.

-5. Prishja e Sabri Novosellës me Xhafer Shatrin

Ardhja e Sabriut nga Turqia në Evropën Perëndimore nuk ishte ndonjë çështje e shpëtimit të vijës së Lëvizjes. Sabriu ishte mërzitur vetëm në Turqi dhe donte të vinte në Perëndim. Si refugjat politik në Turqi ai e kishte shumë vështirë të merr pasaportë. Xhafer Shatri ia dërgoi disa vërtetime e dokumente përmes lidhjeve që kishte me Ramadan Osmanin në Malmo të Suedisë, dokumente e ftesa për vizitë në Suedi, të cilat qenë vendimtare që Sabriut t'i jipet pasaporta e leja për të udhëtuar. Përgatitjet për sigurimin e dokumenteve të udhëtimit Sabriu i ka bërë pothuajse gjatë gjithë vitit 1983. Këto m'i thotë Xhafer Shatri, kur po përgatisnim numrin e dytë të "Zërit të Kosovës", në mars 1983 në banesën e tij në Gjenevë. Ai disa herë u shprehë në formën: "Ta shpëtojmë Sabriun nga shkretinat e Anadollit".

Në fillim të nëntorit 1983 Sabriu erdhi në Gjenevë te Xhafer Shatri dhe dukej sikur "moti ishte i kthjelltë" e çdo gjë do të jetë mirë. Sidomos qëndrimi i tyre ndaj diplomacisë shqiptare ishte pika më unike.

Sabriu sheh se, për gjithë ato kontakte që ishin krijuar përmes adresës së "Zërit" në Biel Bienne, ai ishte i painformuar dhe e ndjen veten të mënjanuar. Divergjenca të tjera lindin edhe për atë se, në historinë e Lëvizjes për Republikë cila datë është më e rëndësishme: 17 shkurti apo 15 maji 1982. Pikë tjetër fërkimi ishin edhe bisedimet e tetorit 1981 të Stambollit me Kadri Zekën, ku Sabriu e paska paraqitur Xhafer Shatrin si anëtar të organizatës së vetë dhe krejt lindjen e OMLK, vetëm si rezultat të këputjes së lidhjeve me LNÇKVSHJ-në.

Sabriu e akuzon Xhafer Shatrin në Gjenevë dhe akuzat i shpërndan përmes telefonit të tij. Akuzat e Sabriut pra nuk ishin ndonjë kritikë, por akuza të vrazhda që kishin për qëllim shkarkimin e Xhafer Shatrit si drejtues të "Zërit të Kosovës", qërimin e hesapeve me te në stilin "ose-ose". Në akuzat e tilla Sabriu mbeti i vetmuar, sepse ato nuk i pranoi askush.

Nga procesverbali i mbajtur prej Ibrahim Kelmendit, del se Xhafer Durmishi, lidhur me fjalët që lëshonte diplomacia shqiptare kundër Xhafer Shatrit në vende të ndryshme tek shumë njerëz e jo vetëm tek Sabriu, i cili u bë zëdhënës i tyre, thotë: "Nuk jam për atë që të bazuar në Shqipërinë të akuzohen shokët". Ky qëndrim i imi ndaj intrigave të diplomacisë shqiptare figuron edhe në letrën e Sabri Novosellës të 16 janarit 1984, dërguar mua e Faridin Tafallarit. Xhafer Durmishi dhe Faridin Tafallari nuk e pranuan propozimin e Ibrahim Kelmendit për përjashtimin e Sabriut nga Lëvizja, dhe kështu erdhi tek një thyerje e re, thotë Sabriu në shkrimin e tij. Pikëpamjet e ndryshme e diametralisht të kundërta të Xhafer Durmishit me Ibrahim Kelmendin kanë qenë rregull dhe votimi i ndryshëm në këtë pikë nuk ishte diçka e re. As Xhafer Shatri nuk ishte për thellimin e acarimeve për faktin e thjeshtë se sulmi i Sabriut mbeti i pa efekt. Kjo nuk do të thoshte se do të vazhdonte loja sikundër nuk ka ndodhur asgjë.

Sabriu ishte i vetmi të cilit i ngutej, ishte i vetmi që kishte interes që përçarjen ta çoi deri në shkëputje. Vetë sulmi i tij nuk kishte qenë i atij lloji për të lënë ndonjë urë lidhjeje. Ai ishte i interesuar për këtë sepse pas atyre sjelljeve, ai kurrë më nuk do të mund

të pretendonte për ndonjë vend me rëndësi në Lëvizje. Prandaj ai vazhdoi me disa "komunikata", "proklamata" e "qarkore" për të cilat vazhdimisht e ngarkon diplomacinë shqiptare.

Fushata kundër meje prej diplomacisë shqiptare, e as ndonjë fjalë e mirë prej tyre (nëse është thënë ndonjëherë) kurrë nuk kanë pas ndikim në vendimet e mia. Fushatat e periferisë (me periferi nënkuptoj edhe intrigat e PPSH) nuk luajnë asnjëherë ndonjë farë roli, në qoftë se ata që ulen në një tavolinë janë unik dhe i mbajnë fjalët edhe pas përfundimit të mbledhjeve.

Komunikatat, qarkoret, një gazetë që doli në Bruksel si organ i një dege të Lëvizjes, pa marrëveshje me udhëheqjen dhe pikëpamjet e ndryshme sollën deri tek shkëputja.

Arsyeja që edhe unë u largova nga Xhafer Shatri e Ibrahim Kelmendi ishin pikëpamjet krejtësisht të kundërta lidhur me qëndrimin ndaj klubeve shqiptare e çështjeve organizative, pikë në të cilën Xhafer Shatri e Ibrahim Kelmendi mendonin njësoj. Për shkak të këtyre dallimeve unë kisha kërkuar dorëheqje nga Qendra Ekzekutive e Lëvizjes, qysh në korrik 1983 e që nuk ishte pranuar.

-6. "Zëri i Kosovës", Suedi

"Zëri i Kosovës" që ka dalë në Suedi, për ndryshim nga shumë gazeta të asaj kohe

- pikë qendrore në politikën e saj nuk e ka pas informatën bardhë e zi, por të përpunoj qëndrimet ndaj
- taktikës për Kosovën Republikë,
- klubeve shqiptare, që kanë qëndruar jashtë Lëvizjes,
- punës ilegale e legale,
- metodave reale dhe atyre aventuriere,
- çështjeve të organizimit,
- punës për nxjerrjen e një gazete,

Me fjalë tjera ta përshkruaj jetën e asaj organizate nga e cila është mundësuar dhe kushtëzuar dalja e tij. Për këtë edhe ka pasur shumë kritika në adresë të tij. Por ato gjithmonë kanë qenë nga një krah më i majtë e "revolucionar". Epitetet kanë qenë: likuidatorë, revizionistë, republikan, dorështrirës etj.

Nga procesverbali i mbledhjeve në banesën e Hasan Malës dhe nga letra e Sabriut e 16 janarit 1984, del se unë nuk i kamë pas kurrë për busull pështpëritjet e Bujar Hoxhës, Ibrahim Qavollit dhe as të Engjell Kolanecit, dhe kam pasë guxim me u deklarua për to, edhe pse dihej se atë proces Sabriu ia dërgonte Ibrahim Qavollit, në konsullatën shqiptare të Stambollit.

Botëkuptimet e mia politike, pikëpamjet e mia mbi zhvillimin historik janë konstante materialiste përkundër furtunave e stuhive kaq të forta duke filluar prej dyfytyrësisë e deri tek njëqindëfytyrësia.

Numri i parë i "Zërit të Kosovës", me adresë në Suedi, doli në qershor 1984. Kjo gazetë doli përafërsisht njëherë në muaj gjer në korrik 1985. Në fillim të shkurtit 1985 Sabri Novosella, për shkaqe e teke të veta, ndoshta i penduar për prishjen e tij me Xhafer Shatrin u distancua krejtësisht nga gazeta "Zëri i Kosovës" me adresë në Suedi. Për këtë ai njoftoi shokët në Shtutgart e Zurich. Në prill apo maj 1985 Sabriu iu mbështetë Hysen Gërvallës, i cili u bashkua me atë pjesë të Lëvizjes që kishte qendrën në Zvicër. Nga kjo rrjedhë se thënia e Sabriut "urdhnova me e ndalë gazetën në Suedi" është falsifikim i të vërtetës.

Pohim tjetër i Sabriut lidhur me "Zërin" që dilte në Suedi: "...e jepte bekimin diplomacia shqiptare për çdo numër të organit".

Unë nuk di asnjëherë se si reagonte diplomacia shqiptare ndaj gazetës. Ata janë interesuar shumë se çfarë po shkruhet dhe kontaktonin vazhdimisht me të gjithë ata që kishin të bënin me gazetën, por kurrë drejtpërdrejt me drejtuesit e gazetave. Sipas logjikës së tyre ai që drejton gazetën duhej vetë të merrte iniciativën për t'i takuar. Në pranverën dhe verën e vitit 1985 thirrjet e kritikat e diplomacisë shqiptare se unë "punoj krye në veti e pa u konsultuar" kanë qenë monotone.

Numri i fundit i "Zërit të Kosovës", Suedi, doli në korrik 1985. Në këtë numër paralajmërohej **ndërrimi i emrit të gazetës dhe emrit të organizatës për të zhdukë përzierjet që bëheshin me atë në Zvicër.** Pas botimit të këtij lajmi, të gjetur para një situate të re, shokët në Gjermani e Zvicër dërguan katër veta në Stockholm dhe e morën makinën e shkrimit me të cilën ishte nxjerrë gazeta. Pra, ai i cili nuk është në gjendje për ta filluar e për ta mbajtë gjallë një gazetë ai kurrë nuk pyetet as kur me e ndërpre atë.

-7. "Zëri i Kosovës", organ i LNÇKVSHJ-së

Në vitin 1979 në statutin e LNÇKVSHJ-së, thuhet organ i saj është "Zëri i Kosovës". Se si duket ky organ para nëntorit të vitit 1981, kur doli numri i parë, i nxjerrur nga Jusuf Gërvalla, unë nuk e di dhe nuk kam takuar asnjë njeri që mund ta qes në tavolinë organin e lartpërmendur. Për këtë arsye ekzistenca e një gazete me emrin "Zëri i Kosovës" si organ i LNÇKVSHJ-së, përderisa të mos vërtetohet e kundërta mbetet një trillim, një çështje që në mungesë faktesh s'ka se si të besohet.

ZËRI I KOSOVËS

Organ i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi

Në ballë të këtij populli dhe këmbët e këtij populli, flijimi dhe vdekja për realizimin e aspiratave të tij, do të na vijnë si përjetimi më i bukur e më fisnik në gjithë jetën. Dhe s'do të ketë forcë që të na ndalë në rrugën tonë të ndritshme. Jusuf Gërvalla

Nr. 3 Mars 1982

ZiK-u Nr.3, Mars 1982 i botuar pas vrasjes së Jusuf Gërvallës

-8. "Zëri i Kosovës", organ i Grupit Komunist të Riza Salihut

Në fillim të vitit 1980 në Kosovë ka qarkulluar një fletushkë e "Grupi komunist Zëri i Kosovës" që është nxjerrë nga Riza Salihu në Shtutgart. Në verën e vitit 1980 Sabri Novosella lajmërohet në Stamboll për fletushkën e Grupit Komunist "Zëri i Kosovës" për çka ai dëshiron t'i sigurohet shpejt një kopje që ta dërgoj në konsullatën e Stambollit dhe t'ua dëshmoj atyre tetekëve se shokët e Sabrisë dhe Komiteti Qendror me Kryetarin e vetë nuk hanë bukë badihava.

Në fund të dhjetorit 1979 Jusuf Gërvalla takohet me Riza Salihun. Në bisedë e sipër Rizahu e pyet Jusufin se çfarë organi nxjerr organizata e juaj. Kur Jusufi i përgjigjet se organ i LNÇKVSHJ është "Zëri i Kosovës", Riza Salihu dëshpërohet e revoltohet

shumë dhe e prishë bisedën me Jusufin. Më vonë kur Jusufi merr kontakt me Sabriun, në një ndër letrat e para i thotë se emri "Zëri i Kosovës" nuk është i përshtatshëm për organizatën tonë pasi të njëjtin emër e përdorë Riza Salihu për grupin e tij. Sabriu i thotë se "Zëri i Kosovës" i grupit të Riza Salihut është diçka tjetër nga "Zëri i Kosovës" i LNÇKVSHJ-së.

-9. "Zëri i Kosovës", organ i LNÇKVSHJ-së, i drejtuar nga Jusuf Gërvalla

Dalja me "Zërin e Kosovës" si organ i LNÇKVSHJ-së ishte planifikuar në verën e vitit 1981, por bisedimet me OMLK-në e që nxirrte revistën "Liria" e pezulluan këtë punë gjer në nëntor 1981, kur doli numri i parë i saj. Në janar 1982 doli numri i dytë. Vetura e Bardhosh Gërvallës në të cilën u vranë vëllezërit Gërvalla e Kadri Zeka ishte e mbushur me këtë numër i cili posa kishte dalë nga shtypshkronja. Mu për këtë, për aktivistët e rrethit të Shtutgartit kjo gazetë mori një përmbajtje shumë më të thellë se sa që kishte pasur përpara.

-10. "Zëri i Kosovës", organ i LRSHJ-së

Në bisedimet e Ankaras të 17 shkurtit 1982 shtrohet pyetja se çfarë emri të ketë gazeta e LRSHJ-së. Për shkak të ngjarjes së 17 janarit, para se të shkojmë në bisedimet e 17 shkurtit ishim marrë vesh me Sabriun që të mbrojmë emrin "Zëri i Kosovës" për organizatën e bashkuar, e cila u quajt LRSHJ me propozim të Osman Osmanit.

Kur Sabriu ua propozoi "Zërin e Kosovës", shokëve të partisë u qitshin sytë xhixha. Kurrsesi- thanë ata në fillim. Ne kemi nxjerrë dy organe, "Revolucionin" si organ të partisë dhe "Atdheun" si organ të rinisë që kanë luftuar për republikë dhe po heqim dorë nga emri i tyre për hir të bashkimit, kurse ju kërkoni ta mbajmë emrin e "Zërit të Kosovës", emër i cili është i kompromet uar me kërkesën për bashkim e për luftë kundër Jugosllavisë. Parimisht ata kishin të drejtë, por nga ato që kishin thënë se kishin bërë kishte aq mendjemadhësi të paskrupullt, kështu që ne nuk besonim aspak se organe të tilla kanë ekzistuar, bashkëbiseduesit nuk shfaqnin ato cilësi që do ta mbushnin mendjen se kanë qëndruar pas çfarëdo gazete që meriton për t'u zënë në gojë.

Shokët e partisë u treguan mosmirënjohës dhe nuk ia dinin aspak për faleminderit Sabriut që e kishte gjet emrin për organin e Lëvizjes, duke lënë të nënkuptohej se bisedimet për bashkim nuk ishin drekë nrikullijash për t'ia ngjitë emrin një foshnje. Por meqë ne nuk u lëshuam pe në këtë pikë ata u pajtuan me këtë, apo thënë më drejtë u detyruan të pajtohen.

Unë e Osman Osmani u kthyem në Gjermani më 22 shkurt 1982. "Zëri i Kosovës", numri i tretë, ishte në fazën përfundimtare. Unë pritja se ai do të dali si organ i LRSHJ-së. Ndërrimi në kokën e organit nga LNÇKVSHJ në LRSHJ ishte një çështje tepër e thjesht. Osman Osmani ndërhyni duke thënë: "Le të del edhe ky numër si organ i LNÇKVSHJ-së në mënyrë që armiku të mos kujtoj se mbas atentatit u shkatërrua LNÇKVSHJ". Ne në rrethin e Shtutgartit nuk e kundërshtuam në këtë pikë. Por e gjithë kjo ishte një dredhi e intrigë e cila kishte për qëllim të vonon çështjen deri më 14 e 15 maj në mënyrë që aty të shtrohej prapë çështja e emrit të gazetës për LRSHJ. Pra në këtë pikë ku ata vetëm nuk kishin mundur të bënin asnjë ndryshim, shpresonin tani më 14 e 15 maj se me ndihmën e Xhafer Shatrit do të bënin ndërrimin e emrit të organit. Xhafer Shatri, si përfaqësues i OMLK-së dhe i revistës "Liria" kishte arsye shumë më të mëdha që të kërkonte një emër më neutral se sa "Zërin e Kosovës", për LRSHJ. Por emri i "Zërit të Kosovës" nuk u ndryshua as më 15 maj, përkundër faktit se ishte e vetmja pikë që u diskutua.

-11. “Zëri i Kosovës”, organ i Grupit Revolucionar të Xhafer Shatrit

Më vonë, në vitin 1984 Xhafer Shatri shkroi një artikull, sipas të cilit një gazetë që ka dalë me emrin “Zëri i Kosovës” diku në vitet 1970 ka qenë organ i Grupit Revolucionar.

-12. Kronologji e shkurtër ngjarjesh në jetën e organizatave në mërgim

Verë 1979: Ibrahim Kelmendi nxjerr numrin e parë të “Bashkimit”, organ i Frontit të Kuq.
Dhjetor 1979: Jusuf Gërvalla arratiset nga Kosova dhe shkon tek vëllai i tij Bardhoshi në Gjermani, në Shtutgart.
Shkurt 1980: Jusuf Gërvalla nxjerr numrin e dytë të “Bashkimit”.
Maj 1980: Jusuf Gërvalla nxjerr numrin e tretë të “Bashkimit”.
Gusht 1980: Jusuf Gërvalla nxjerr numrin e parë të “Lajmëtarit të lirisë”.
Tetor 1980: Jusuf Gërvalla nxjerr numrin e dytë të “Lajmëtarit të lirisë”. Në Zvicër del numri i parë i “Lirisë”, organ i OMLK-së.
Dhjetor 1980: Del numri i dytë i “Lirisë”.

Janar 1981: Jusuf Gërvalla nxjerrë numrin e fundit të “Bashkimit”, të katërtin me radhë, dhe ndërprenë bashkëpunimin me Ibrahim Kelmendin, në cilësinë e Redaktorit të “Bashkimit” dhe të ideologut të Frontit të Kuq Popullor. Del numri i tretë dhe i fundit i “Lajmëtarit të lirisë”.
Maj 1981: Jusuf Gërvalla ndihmon dhe bënë përgatitjen teknike të numrit të tretë të “Lirisë” dhe organizon dërgimin e saj në Kosovë.
Prill-Maj-Qershor 1981: Punë e madhe praktike për organizimin e tetë demonstratave në qendra të ndryshme të Evropës në përkrahje të demonstratave të Kosovës në Pranverën 1981.
Korrik 1981: Jusuf Gërvalla ndihmon me artikuj dhe përgatitë teknikisht numrin e dyfishtë 4-5 të “Lirisë” dhe organizon dërgimin e saj në Kosovë.
Shtator 1981: Dalin Tezat rreth Frontit për Republikë, të OMLK-së.
Tetor 1981: Në Stamboll mbyllen pa rezultat bisedimet për bashkim në mes Sabri Novosellës dhe Kadri Zekës. Me propozim dhe me kërkesë të Sabri Novosellës, Jusuf Gërvalla fillon të nxjerrë “Zërin e Kosovës” si organ të LNÇKVSHJ-së.
Nëntor 1981: Del numri i parë i “Zërit të Kosovës”, i LNÇKVSHJ-së.

Janar 1982: Del numri i dytë e “Zërit të Kosovës”, i LNÇKVSHJ-së.

Në Untergruppenbah, në mbrëmjen e 17 janarit 1982 nga armiqtë e popullit shqiptarë vriten vëllezërit Gërvalla dhe Kadri Zeka.

5 shkurt 1982: Varrosen vëllezërit Gërvalla e Kadri Zeka, në varrezat kryesore të Shtutgartit.
17 shkurt 1982: Në orët e vona të natës përfundojnë bisedimet për bashkim në mes LNÇKVSHJ-së e PKMLSHJ-së në Ankara. Në bisedime marrin pjesë Sabri Novosella, Xhafer Durmishi, Abdullah Prapashtica, Osman Osmani dhe Faton Topalli.

Mars 1982: Del numri i “Zërit të Kosovës”, (pas atentatit të 17 janarit) nën drejtimin e Xhafer Durmishit.
3 prill 1982: Demonstratë e shqiptarëve në Bon.
24 prill 1982: Demonstrata e parë shqiptare në Vjenë.
14 maj 1982: Në Biel Bienne takohen Xhafer Shatri, Osman Osmani dhe Xhafer Durmishi. Përkundër kërkesave të Osman Osmanit e Xhafer Shatrit për ndryshimin e emrit të organit, “Zëri i Kosovës” mbetet organ i LRSHJ-së. Në takim ndahen detyrat, ku Xhafer Durmishi ngarkohet të vazhdoj me nxjerrjen e organit të Lëvizjes. Pjesërisht me shkrime dhe me përgatitjen e plotë teknike merret gjer në mars 1983.
Takimi i 14-15 majit 1982 është i pari dhe i fundit ku ishte e pranishme ajo pjesë që rridhte nga PKMLSHJ-ja.
Qershor 1982: Del në Shtutgart numri i parë i “Zërit të Kosovës” si organ i Lëvizjes për Republikë. (ZiK-u, Organ i LRSHJ-së, Nr.1 Qershor 1982)
26 qershor 1982: Demonstratë e koordinuar shqiptare në Bern dhe Sydnay të Australisë, në ditën e fillimit të punimeve të Kongresit XII të LKJ.
Dhjetor 1982: Demonstrata më jehonëmadhe deri atëherë (e para e mbajtur në një ditë pune) në Gjenevë, më 10 dhjetor 1982, me rastin e ditës për të drejtat e njeriut.

Janar 1983: Mbledhje në banesën e Hafiz Gagicës. Marrin pjesë: Xhafer Shatri, Hasan Mala, Ibrahim Kelmendi, Xhafer Durmishi. Zgjidhet Qendra Ekzekutive (emër i propozuar prej Xhafer Shatrit) e Lëvizjes. Ndahen këto detyra:

Xhafer Shatri- nxjerrjen e gazetës,
Faredin Tafallari- arkëtar,
Hasan Mala- lidhjet me Kosovën,
Ibrahim Kelmendi- lidhje me organizata të jashtme,
Xhafer Durmishi- çështjet organizative në mërgim, relacionet me klubet shqiptare.

Mars 1983: Del numri i dytë i (për vitin 1983) “Zërit të Kosovës” në Gjenevë nga Xhafer Shatri e Xhafer Durmishi, dhe pas përfundimit të punimeve bëhet një mbledhje e Qendrës Ekzekutive. Hasan Mala dhe Faridin Tafallari votojnë për pikëpam-jet e Xhafer Durmishit lidhur me qëndrimin ndaj klubeve shqiptare në mërgim.

Korrik 1983: Në një shtëpi malore në Zvicër bëhet një tubim i madh i aktivistëve më të dalluar të Lëvizjes në Evropë si dhe përfaqësues klubesh. Merret një vendim për themelimin e një Bashkësie të klubeve shqiptare dhe demaskohet puna intriguese e PKMLSHJ-së. Në mbledhjen e Qendrës Ekzekutive që mbahet pas tubimit, Xhafer Durmishi kërkon dorëheqje për shkak të pikëpamjeve të kundërta me Ibrahim Kelmendin e Xhafer Shatrin në çështjen e klubeve shqiptare dhe punën e tyre.

Nëntor 1983: Sabri Novosella vjen nga Turqia në Gjenevë te Xhafer Shatri dhe pas disa ditësh i bënë një varg akuzash. Akuzat e Sabri Novosellës hidhen poshtë nga të gjithë.
Mars 1984: Mbledhje në Gjenevë ku marrin pjesë Xhafer Shatri, Ibrahim Kelmendi, Faridin Tafallari dhe Xhafer Durmishi.
Qershor 1984: Del “Zëri i Kosovës” në Suedi. Gjatë vitit 1984 dalin 5 numra.

Korrik 1985: Del numri i fundit i “Zërit të Kosovës” në Suedi. Gjatë vitit 1985 dalin 8 numra. Pjesa më e madhe e atyre që e kanë përkrahë këtë gazetë u aktivizuan në partitë e ndryshme demokratike të Kosovës.

P. S - Këtë shkrim e kam kryer në maj të vitit 1992. Ka qenë i paraparë si reagim ndaj një shkrimi të Sabri Novosellës botuar në "Zëri", por "Zëri" e ka cunguar dhe ka botuar vetëm një pjesë të vogël të tij. Autori-Xhafer Durmishi

3. PËR MUA NUK LUAN AS ROLIN MË TË VOGËL

-1. Letër për Premton dhe Donika Gërvallën, 12 maj 2007
-2. Letër nga Donika Gërvalla, 12 maj 2007
-3. Letër për Donika Gërvallën, 13 maj 2007
-4. Vazhdim i letrës së 13 majit 2007

Qysh prej vitit 2000, unë i kisha të sistemuara të gjitha citatet nga ato letra të Jusuf Gërvallës, të cilat i kisha marrë nga librat e Faridin Tafallarit, të botuar më 1997 e 1998, si dhe ato citate të letrës së Jusufit, të 5 nëntorit 1981, dërguar Sabri Novosellës, të përdorura në librin Fati i luleve, nga Kadri Rexha. Edhe pse letrat e Jusufit, të botuara deri në vitin 1998 më jepnin një bazë solide për argumentet e mia, megjithatë mungonin pjesë të rëndësishme të fjalëve të Jusufit, ku ekzistenca dhe thelbi i përmbajtjes së tyre ishin të qarta për mua, por më mungonte teksti i plotë.

Nga Suzana Gërvalla, në fillim 2004 kisha mësuar se po përgatitet botimi komplet i veprës së Jusufit, që ajo e planifikonte të bëhet rreth 1 tetorit 2005 (60-vjetorit të lindjes së Jusufit). Këtë botim e prisja me interesim pasi shpresoja se do të njihem me përmbajtjen e të gjitha letrave të Jusufit në Gjermani, dhe ndonjë shënimi tjetër. Por punët nuk u zhvilluan me atë ritëm.

Më 5 shkurt 2007 Ibrahim Kelmendi e promovoi librin "Atentatet" në Hotel Viktoria në Prishtinë. Premton Gërvalla, gjatë prillit 2007, më bëri shumë pyetje për librin Atentatet dhe të gjitha pyetjeve të tij, në mënyrë të pakursyer e pa asnjë rezervë iu përgjegja. Përmbajtja e këtij libri më shtyri t'u drejtohem Premton dhe Donika Gërvallës të më ndihmojnë, dhe të ma japin mundësinë me e pasë në dorë një letër të Jusufit, atë që ia ka dërguar Kadri Zekës, rreth 7 dhjetorit 1981. Mendoja se ata edhe pa këtë ngjarje (pa botimin e librit Atentatet) janë duke e planifikuar botimin e veprës së plotë të Jusufit, dhe duke pasur parasysh të kaluarën, edhe nëse ma mundësojnë me i pasë në dispozicion një apo dy letra të tij, nuk do të humbnin asgjë. Në të kundërtën mua me mbetej të prisja për ndonjë kohë, secilin tetor apo 17 janar, sepse më ishte thënë se nuk do të vononte dhe unë do të kisha mundësinë t'i lexoja të gjitha letrat dhe shënimet tjera në veprën komplete të Jusuf Gërvallës, e cila po përgatitej për botim qysh nga pranvera e vitit 2004. Drejtimi im që të më ndihmojnë në këtë pikë dhe përgjigja prej tyre janë të pasqyruara në pjesët prej katër letrave të mëposhtme.

-1. Letër për Premton dhe Donika Gërvallën, 12 maj 2007

(Pjesë e letrës)

Të dashur Premton e Donikë,

Rrethanat e demonstratave të vitit 1981 ndikuan që unë të njihem me babain dhe familjen tuaj në situatat më dramatike që arritën kulmin në mbrëmjen e 17 janarit 1982. Atëherë ju ishit ende fëmijë por edhe unë, sa i përket numërimit të viteve isha shumë i ri. Sa isha i pjekur dhe a ishte burrërore sjellja ime në ditët që pasuan është çështje tjetër dhe i tejkalon kufijtë e kësaj letre. Valët e jetës na shkapërderdhën në drejtime të ndryshme. Për aq sa kam mund, me kujdes kam përcjellë rrugët tuaja nëpër jetë, vendosjen në Shqipëri, e disa turbulenca e përjetime të cilat i kam kuptuar më së shumti vetëm pasi kam lexuar dramën "Misioni" të Sabri Hamitit. Më ka ardhur shumë keq kur kam kuptuar

mënyrën se si i keni përjetuar ditët e para pas atentatit dhe ditën e varrimit, më 5 shkurt 1982, në bazë të asaj që përshkruhet në dramën e lartpërmendur. ...

Për kohën janar 1980 – janar 1982 nuk kam shkruar deri më sot përveç një shkrimi shumë konciz, të vitit 1992, i cili është si përgjigje në një shkrim të Sabri Novosellës.

Në tetor të vitit të kaluar botova artikujt e zgjedhur që kam shkruar në vitet 1981-1985, të përmbledhur në botimin "Protesta e Aspirata". Aty ua kam dhënë përgjigjen të gjitha pyetjeve teorike me të cilat jemi ballafaqua në atë kohë.

Pas pastrimit të kokës nga gjërat të cilat veç i kam thënë, i kam pas hy dhe jam duke u marrë me disa gjëra që nuk i kam thënë asnjëherë gjer më tani. Në ndërkohë doli Ibrahim Kelmendi me librin e tij "Atentatet" me sulme e shpifje të ndyra ndaj disa shokëve dhe meje. Akuzave të tij në një mënyrë do t'u përgjigjem. Për këtë nuk më nevojitet ndihma artistike, krijuese e ideore e askujt. Debatet që i kam pasur më parë me të tjerët, sa i përket penës, i kam zgjedhur të gjitha vetë. Sulmi me ndihmën e një grupi, kolektivi më duket i ulët dhe unë kurrë nuk e sulmoj as demaskoj dikend duke kërkuar ndihmën e shumë emrave. Mbrojtja e sulmi në bllok është i denjë për hijenat. Ajo çka do të më ndihmonte shumë janë pak letra e dokumente që i keni ju në Prishtinë. Këto janë:

Një dokument të Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës i dërguar kah fundi i vitit 1981, me titullin: "Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!". Përgjigja e Jusufit që ia bënë Kadri Zekës lidhur me dokumentin e mësipërm.

... Premtoni ishte tek unë dhe folëm për këtë dhe ai nuk e shikoi çështje problematike sigurimin e tyre. Kam përshtypjen se Suzana konsideron, si më 1996 "se unë jam tepër e padenjë për këtë punë, se kjo është për një historian të denjë."

Dokumentet e kërkuara nuk besoj se është vështirë për t'u siguruar nëse ekziston vullneti. Ato, nëse më jepni nga një kopje, do të doja t'i kisha pa ndonjë kusht. Në punën time, busulla ime nuk është ideja që ajo që shkruaj t'i pëlqej këtij apo atij. Këtu po shtoj se jam kategorikisht kundër disa formulimeve që i keni në faqen e internetit www.gervalla.org dhe jam kundër fotografisë së zgjedhur. Potencimi i aspektit kulturor e muzikor në kurriz të luftëtarit të lirisë është taktikë sa naive aq edhe djallëzore. ...

Kjo që po kërkoj nuk më duket e paarsyeshme. Unë po kërkoj disa fakte që t'i vendosi në një tërësi, fakte që veç ekzistojnë, t'ua bëjë një interpretim (besoj më të drejtin). Unë nuk po dua t'ua vjedhë ndonjë ide, a të kërkoj bashkautorësi nga askush.

Përshëndetje shoqërore

Xhafer Durmishi

-2. Letër nga Donika Gërvalla, 12 maj 2007

(Disa citate)

"...Ne jemi njohur në rrethana jo të zakonshme si për Ty, ashtu edhe për mua. Ti, Hafizi dhe të tjerët i keni përjetuar vrasjen dhe vitet që kanë pasuar si të rritur, edhe pse shumë të rinj. Ndërsa unë i kam përjetuar nga këndvështrimi i fëmisë që humbet babain dhe për hir të tij dhe për të shpëtuar kujtimet për te mbahet fort pas secilit që ndjen që i ka qëndruar afër babait të vdekur.

Unë nuk e mbaj mend, të them të drejtën hollësisht se çfarë shkruan Sabri Hamiti në dramën e tij. Si çdo vepër artistike aty do të ketë edhe ndonjë detaj të vërtetë.... Nëse për ty është me rëndësi, atëherë unë do ta lexoja edhe njëherë dhe do të të tregoja mendimin tim rreth dramës.

Se çfarë shkruan Ibrahim Kelmendi ***mua nuk më intereson fare****! Unë Ibrahim Kelmendin kam pasur mjaft kohë ta njoh mirë edhe gjatë këtyre 15 viteve të fundit që jetoj vetë në Gjermani. Se çfarë shkruan Ibrahim Kelmendi për njërin dhe tjetrin* ***për mua nuk luan as rolin më të vogël****. ...*

Së fundi, përsa i përket mendimit tënd për faqen gervalla.org aty ka dy gjëra për të thënë.... Unë jam shumë e hapur së paku për të dëgjuar. Unë vërtet në fund bëj atë që mua më duket e udhës, por jam e hapur për të dëgjuar jo sa për sy e faqe por me gatishmërinë për të vënë në pyetje të gjitha pozicionet e mia ***që kanë të bëjnë me babain tim.***

-3. Letër për Donika Gërvallën, 13 maj 2007

(Pjesë e letrës)

... Frekuenca e kontakteve me dikend nuk qëndron gjithmonë në proporcion të drejtë me afërsinë. Dramën e Sabri Hamitit nuk kërkoj ta lexosh. Ajo çfarë është shkruar është shkruar. Nëse i bëjë ndonjë koment më duket se më ndershmërisht e bëjë unë se ndonjë tjetër e edhe se vet Sabri Hamiti. Drama nuk më duket aspak artistike. Më ngjan më shumë si incizim bisedash me magnetofon pa kurrfarë stilizimi e ndreqje.

Sa i përket librit të IK nuk mendoj të shkruaj enkas vetëm për te. Por në kalim e sipër pasi t'u bëjë një vështrim të gjitha shkrimeve (librave) që janë botuar për apo rreth Jusufit dhe të gjitha atyre që janë shkruar nga J. e që i disponoi do të ndalem për aq sa është e nevojshme edhe tek IK. Megjithëse nuk kam ende ide përfundimtare si t'ia bëjë teknikisht në këtë pikë. ..

Ndeshja me kokëfortë kurrë kokëçarje nuk më ka sjellë. Kokëçarjet më të mëdha i kam pas me kameleonët. Fatmirësisht, duke iu falenderuar kushteve modeste por të sigurta ekonomike në Suedi, bëjnë që unë të kursehem nga takimet e panevojshme me kameleon. Kënaqësia ime me ta kufizohet në shikimin e programeve të National Geografic.

Nëse dokumentet e kërkuara gjenden tek ti do të ishte shumë mirë. Nëse jo kishte mund me i dërgua Suzana.

...Gabime kardinale, jo anësore që kanë të bëjnë me palcën kurrizore gjenden në faqen e fondacionit në internet. Kur jemi tek faqja po të them kështu: Gabimi i parë – potencimi në radhë të parë i anës letrare artistike ndaj asaj të ideologut të lëvizjes kombëtare e të shtresave të vegjëlisë. Fjala veprimtar politik (në këtë rast) nuk thotë asgjë...

Gabim tjetër kardinal: Krahasimi i Kosovës me regjimet e Evropës lindore. Ky krahasim është krejtësisht i gabuar. Krahasimi është i qëlluar për gjerman por për shqiptar, për Jusufin aspak. Unë e kuptoj se ka disa nyje të forta që duhen zgjedhë. Ju e keni zgjedhë rrugën më të lehtë, njëkohësisht të gabueshme. Pasi J. ka glorifikuar E. Hoxhën me "duar të përgjakura" në atë drejtim nuk kemi se me çka të lavdërohemi. Çka na mbetet: Kënga, gazetaria e Rilindjes, veprimtari politik, Gitara etj....

Sa i përket çështjes për një vizitë timen në Gjermani. Puna qëndron kështu. Me gjithë qejf do të kisha dalë po të kisha mendime të përfunduara e të kristalizuara për këtë çështje. Unë jam në mes të punës. Tema është komplekse. E ndiej thellë se kam obligim ndaj Teje ... të tregoj gjithçka që di në mënyrën më të mirë. Por unë këtë obligim e kam edhe para dyqind punëtorëve që për hir të bashkangjitjes punës së Jusufit kanë qëndruar larg familjeve për 20 vjet. Janë afër 40 veta që në emër të Lëvizjes së Jusufit janë dënuar me 200 vjetë burg. Satisfaksion i madh për ta është se Jusufi ka shkrua për punën e tyre gjatë katër muajve. Me gjithë dëshirë do të dilja por nuk mund të dalë njëherë se jam duarthatë.

-4. Vazhdim i letrës së 13 majit 2007
(Pjesë e letrës)

Me këta rreshta nuk kam dëshirë të të ç'vendosë vëmendjen nga punët e tua të shumta. Me këtë rast vetëm dua të rrumbullakësoj disa gjëra që i kam përshkruar në letrën paraprake, të cilën ta kam kthyer jo krejtësisht të përfunduar. Dërgesën e shpejt ta kam bërë për të treguar respektin tim.

Unë nuk kam kërkuar kurrë dhe as këtej e tutje nuk kërkoj që të tregohet ndonjë vëmendje e posaçme ndaj meje. Ti ke qenë vetë zëdhënëse e një partie politike. Kujdes të veçantë meritojnë kryesisht ata që nuk kanë aftësi të kenë zë personal. ...

Sa i përket çështjes së asaj se pronë e kujt është Jusufi unë këtë çështje e kam zgjedhë më duket në mënyrë mjaftë të mirë dy javë ditë pas atentatit, në fjalimin e shkruar nga unë, që është lexuar tek varret nga Remzi Ademaj me titull: "Ju u bëtë pronë e brezave". Atij artikulli asnjë fjalë nuk do t'ia kisha ndryshua sot dhe çuditem kush ma ka diktua.

Unë kurrë në jetë nuk do të kem ndonjë çështje kontestuese me Ju në këtë pikë. As nuk do të jap kurrë më ndonjë mendim personal që nuk më kërkohet. Unë me vërejtjet e mia në letrën e mëparshme nuk kam kërkuar të jem bashkautor i faqes (tuaj të internetit-shën im). .... Por ta dish se çdo germë që bëhet publike është automatikisht objekt i kritikës pozitive apo negative nga çdo kush duke përfshi këtu edhe veten time, pasi çështja e Jusufit shumë pak njerëz me ndjenja i len indifirent. Ti e shikon lidhjen e gjakut me Jusufin si privilegj suprem e të padiskutueshëm. Por kjo sjell edhe disa vështirësi që duhet pas parasysh. Nëse thoni gjëra të pamatura e të gabueshme e dëmtoni veten dhe Jusufin. Nëse thoni gjëra të mira e në superlativ, nëse zotnat ua japin talentin e të shprehurit të Shekspirit e të Goethe-s ju prapë keni probleme sepse me e lavdua prindin e vetë nuk ka shije dhe nuk ka lidhje me estetikë tek asnjë komb.

Qëllimi im i parë dhe më i rëndësishëm është t'i përmbledhi me shkrim dhe t'i publikoj shënimet e mia që kam kryesisht për periudhën 1980-1982. Unë nuk kam kurrfarë lakmish, aspiratash praktike personale në asnjë drejtim e më së pakti të ndërhyj në punët Tuaja. Kjo do të thotë se si individ i lirë, pa obligime ndaj asnjë organizate e rrethi privat apo të organizuar, në mendimet e mia për Jusufin (do me thënë vetëm e vetëm për lidhjen e tij me Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare nën Jusgosllavi -shën im) nuk bëjë në parim asnjë kompromis me askend.

4. PA TRAZIME
Korrespondenca ime me Ramadan Pllanën

AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË
P - nr. 137/80, datë 4 qershor 1980
N Ë E M Ë R T Ë P O P U L L I T

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtari Isak Nishevci. kryetar, gjyqtari Metush Sadiku dhe gjyqtarët porotë Azem Emini, Maksimoviq Dojqin dhe Qazim Goxhufi, anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bedrije Kasumi punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale të akuzuarëve:

A K T GJ Y K I M

Të akuzuarët:
Ramadan Pllana, i lindur më 6 korrik 1947 në fshatin Shtitaricë, KK Vushtërri, ku edhe jeton, ka kryer vitin e tretë të Fakultetit filozofik - dega e gjuhës Frenge.

JANË FAJTORË

Dhe atë:

I akuzuari Ramadan Pllana

Gjatë vitit 1978 në Konviktin e studentëve në Prishtinë, organizoi dhe formoi grupin ilegal armiqësor "Shkëndija e Kuqe", me përbërje prej pesë anëtarësh, të akuzuarit Ramadan Pllana si kryesor dhe anëtarëve Abdullah Hoxha, Musa Neziri, Demë Jashari e Latif Pllana, e pastaj të njejtëve u jep për lexim dhe përpunim literaturë e material propagandues duke i përfituar në këtë mënyrë që të punojnë armiqësisht ndaj sistemit të RSFJ, në fillim të vitit 1979 pas shumë kontakteve e bisedave të mëparshme gjatë viteve 1977 e 1978 që i pati me të akuzuarin Shefqet Jashari, nga ky është njohtuar se u pranua për anëtarë të "Komitetit Qendror" dhe ka marrë instrukcione që grupin armiqësor "Shkëndija e Kuqe" ta pagëzoi me emrin e ri "Organizata e Rinisë së Lëvizjes Nacionalçlirimtare Kosovare" me ç'rast ai përveç udhëzimeve për punë konspirative dhe formimit të grupeve të "Treshit", mori "Letrën përshëndetëse", "Betimin", "Vendimin" e pajtimit për bashkangjitje "Lëvizjes", "Vendimin" mbi formimin e grupit në emër të ri, pastaj më 12 mars 1979 në "Tokë bashqe" në Prishtinë me anëtarët e grupit të vet e mban mbledhjen ku e japin betimin dhe marrin përsipër detyrën e formimit të grupeve të reja të "Treshit".

Prandaj gjykata në bazë të neneve të lartcituara si dhe neneve 5, 33, 38, 41 dhe 50 të LPJ si dhe nenit 351 të LPP i

GJ Y K O N

Të akuzuarin Ramadan Pllanën me dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) vjetësh.

-1. Letër nga Xhafer Durmishi, 7 mars 2007
-2. Letër nga Xhafer Durmishi, 29 mars 2009
-3. Letër nga Ramadan Pllana, 30 mars 2009
-4. Letër nga Xhafer Durmishi, 30 mars 2009
-5. Letër nga Ramadan Pllana, 30 mars 2009
-6. Letër nga Xhafer Durmishi, 31 mars 2009
-7. Letër nga Xhafer Durmishi, 15 tetor 2009
-8. Letër nga Ramadan Pllana, 17 tetor 2009
-9. Letër nga Xhafer Durmishi, 20 tetor 2009
-10. Letër nga Ramadan Pllana, 27 tetor 2009
-11. Letër nga Xhafer Durmishi, 27 tetor 2009
-12. Letër nga Xhafer Durmishi, 10 nëntor 2009
-13. Letër nga Ramadan Pllana, 10 nëntor 2009
-14. Letër nga Xhafer Durmishi, 11 nëntor 2009
-15. Letër nga Ramadan Pllana, 12 nëntor 2009
-16. Letër nga Xhafer Durmishi, 12 nëntor 2009
-17. Letër nga Xhafer Durmishi, 29 nëntor 2009
-18. Letër nga Xhafer Durmishi, 7 dhjetor 2009

-1. Letër nga Xhafer Durmishi, 7 mars 2007

"Shkrim nga viti 1992
Fili i bashkangjitur: Organizatat politike shqiptare në Evropë 1981-1985

Mirë mbrëma (nata) Ramadan,

Po kthehem pak tek biseda që e patëm para dy netësh në telefon.

Ti, e ne kemi ba një mund për çështje të vendit tonë. Prandaj mua nuk më pëlqen aspak që dikush nga larg që nuk ka haber me punët tona të çohet e të na trajtoj si analfabet që ndihet i thirrur të na e shkruaj historinë sepse ne nuk po ditkemi.

Ti duhet vetë të shkruash gjithçka din e në Vushtrri ka mjaft gjuhëtarë që din me ta korrigjua e me ta ndreq tregimin tënd e me e botua pikërisht ashtu siç don ti.

Po ta dërgoj një shkrim që e pata shkruar si reagim të një shkrimi të Sabri Novosellës në maj të vitit 1992. Nuk e di a të ka ra në dorë. Shefqeti e ka dhe disa herë e ka cituar në shkrimet e veta. Sivjet me rastin e 25 vjetorit të 17 janarit 1982, "Epoka e re" e ka ribotuar në 4 vazhdime.

Përshëndetje miqësore, Xhaferi

-2. Letër nga Xhafer Durmishi, 29 mars 2009

I nderuari Ramadan,

Po ta përcjellë këtë shkrim të Sabri Novosellës të Botuar në vazhdime në "Bota Sot" vitin e kaluar.

Përshëndetje, Xhafer Durmishi

-3. Letër nga Ramadan Pllana, 30 mars 2009

Shumë i nderuari Xhafer,
Të falenderoj nga zemra për shkrimin që ma dërgove!
Kjo për mua ka shumë rëndësi sepse po informohem për gjysmën, realitetin e veprimtarisë së Sabriut.
T'u kisha lutur, si vëllaut, që të ma dërgosh edhe pjesën tjetër, sepse unë e mora deri këtu, që vijon më poshtë:

"Partia ka shumë kujdes ndaj grave!

Në sallën e ngrënies ishte një televizor. Nuk punonte mbasi nuk kishte antenë. Dy herë e sollën antenën, por televizori punonte vetëm atë natë. Sapo mbyllej programi, punëtorët e vidhnin kabllon e antenës.

Në ditën që po largohej Sabriu nga Shqipëria, befas i plasi vaji që s'mund ta ndalte fare. E ndjeu thellë në zemër një dhembje për gjendjen në të cilën e la Shqipërinë, e veçmas për pamundësinë për të qëndruar"...pjesa tjetër e emailit është boshe, d.m.th. pa asnjë fjalë.
Duke të dëshiruar shëndet e gjithë të mirat, prano përshëndetjet e mia më të përzemërta!
Ramadan Pllana

-4. Letër nga Xhafer Durmishi, 30 mars 2009

Mirë dita Ramadan,
Po ta dërgoj shkrimin prapë në një file të veçantë në Word.
Përshëndetje, Xhaferi

-5. Letër nga Ramadan Pllana, 30 mars 2009

Xhafer i nderuar,
Shkrimi më erdhi i tëri për të cilin të falenderoj dhe të jem mirënjohës. Sa çudi, me ne shqiptarët, kur lejojmë që dikush të luan me besimin tonë!

Tradhtia nuk ka brira! Askund nuk përmendet "Komiteti" në emër të të cilit na mashtroi e na tradhtoi , ky "pehlivan" turkoman!...

Të përshëndes vëllazërisht! Ramadani

-6. Letër nga Xhafer Durmishi, 31 mars 2009

Mirë mbrëma Ramadan,

Mua më është dukur shkrim shumë i thatë, pa fakte, i dobët dhe me thanë të drejtën jam befasue nga dobësia e tij.

Përshëndetje, Xhaferi

-7. Letër nga Xhafer Durmishi, 15 tetor 2009

I nderuari Ramadan,

Këto dy fotografi po ti dërgoj që ti kesh edhe ti. Ndoshta të hyjnë në punë për botimet e tua publicistike e shkencore.

Shumë të fala, Xhafer Durmishi

-8. Letër nga Ramadan Pllana, 17 tetor 2009

Shumë i nderuari Xhafer,

Shumë të falenderoj për emailin dhe dy fotografitë e varrezave të dëshmorëve, pishtarëve e vëllezërve tanë të idealit, Jusufit, Kadriut e Bardhoshit!

Unë jam duke përgatitur, aq sa po mundem, një shkrim historik për Metush Krasniqin, po të them të drejtën edhe nuk po kam mundësi objektive, se kisha pasë dëshirë të takohem me shumë persona me të cilët ka vepruar ky atdhetar i paepur, njëri ndër ideologët e çështjes sonë kombëtare, me ata që ka qenë më i afërm. Përveç Shefqet Jasharit asnjë nuk më ka dhënë material sa duhet, vetëm fjalë. Për mua mbetet enigmë, besoj edhe për ty ashtu, se çfarë marrëdhëniesh kanë pasur Jusufi e Metushi, dy ideologët e LNçKVSHJ-së?! Kurse Sabriut nuk i besoj... Të përshëndes me dëshirën që të jesh mirë si me shëndet ashtu edhe në pikëpamjet e jetës sate të përgjithshme! Përzemërsisht Ramadani

-9. Letër nga Xhafer Durmishi, 20 tetor 2009

Shumë i nderuari Ramadan,

Ekziston një libër për Metushin që e ka shkruar Kadrush Sylejmani, të cilin e kam lexuar por librin nuk e kam më. Libri i këtij Kadrushit është i sponsoruar me aq sa më kujtohet nga djali i Metushit. Mehmet Hajrizi e ka shkruar një libër, "Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981". Këtë libër e kam huazuar nga një shok dhe e kam lexuar deri në faqen 40. I ka gjithsejtë mbi 500 faqe. Që në hyrje, në faqe 11 shkruan: "Natën e 17 janarit 1982 në Untergruppenbach të Gjermanisë kanë ndodhur tri ngjarje historike për Kosovën: Në bazë të Tezave të Frontit për Republikën e Kosovës, u arrit marrëveshja e bashkimit të tri organizatave çlirimtare shqiptare, u vranë tre sendërtuesit e atij bashkimi dhe pushoi së vepruari Organizata Marksiste-Leniniste e Kosovës (OMLK), e cila po mbushte dymbëdhjetë vjet veprimi të pandërprerë në shërbim të lirisë së Kosovës."

Mua m'u duk hyrje interesante.

Shumë të fala, Xhafer Durmishi

-10. Letër nga Ramadan Pllana, 27 tetor 2009

I nderuari dhe i paharruari Xhafer,

Më vjen mirë që komunikojmë herë pas herë. me anë të elektronikës, gjë që kam një kënaqësi nostalgjike meqë na lidhë ish-Organizata jonë, LNçKVSHJ-ja dhe ideologu ynë i pavdekshëm - dëshmori kombëtar Jusuf Gërvalla. Unë jam rregullisht duke mbledhur, me kufizime subjektive e objektive, materiale për Metush Krasniqin, gjithashtu një nga ideologët e frymëzuesit tanë kombëtar. Jam duke punuar nga pak dhe kushtet materiale nuk po më mundësojnë më tepër... Me ketë rast t'u kisha lutur, nëse ka mundësi, që t'më tregosh "enigmën" e një fjale, që gjendet në faqën 7 të librit tënd "Protesta e Aspirata" kur thua " Me këtë rast dua të them se E. Hoxha, për mua dhe për Atë që e çmoj më së shumti në këtë jetë,....etj. Fjala "për Atë" a është për Jusuf Gërvallën?! Të falenderoj për sqarim! Xhafer me kaq po e përfundoj këtë mini-letër duke të dëshiruar shëndet e gjithë të mirat!

Vëllazërisht Ramadani

-11. Letër nga Xhafer Durmishi, 27 tetor 2009

I nderuari Ramadan,

Lidhur me pyetjen tënde, po të përgjigjem: Me "Atë" kam menduar në Jusuf Gërvallën.

Lidhur e punën rreth Metush Krasniqit më vjen mirë që po merresh me te. Të shkruash për Metushin më duket punë më delikate dhe më e zorshme se sa për Jusufin, pasi Metushi me aq sa dihet deri më sot, nuk më ka ra ndonjë material me shkrim nga dora e tij. Me këtë nuk dua ta nënqmoj në asnjë mënyrë veprimtarinë e tij organizative, ndikimin e autoritetin e fjalëve të dala nga goja e tij. Deri më sot Sabriu më së shpeshti ka folë në emër të Metushit dhe fjalët e veta të pa peshë i vendosë në gojën e Metushit për t'iu dhënë njëfarë peshe. Të vendosësh fjalët e tua në gojën e tjetërkujt nëse është fjala për talent të madh kjo mund të jetë edhe e suksesshme. Sabriu por edhe Kadrush Sylejmani në këtë pikë kanë dështua plotësisht.

Jam duke e lexuar në libër interesant që është mirë ta sigurosh nëse ende nuk e ke. Rasim Selmanaj ka mbledhë disa materiale nga autor të ndryshëm sidomos për Jusufin. Libri quhet "Heroi me kitarë", e ka botuar Focusi më 2007.

Shumë të fala, Xhafer Durmishi

-12. Letër nga Xhafer Durmishi, 10 nëntor 2009

I nderuari Ramadan,

Falemnderit për shkrimet që m'i ke dërguar me qëllim që të më informosh (dhe jo të kërkosh ndonjë mendim apo qoftë edhe një vërejtje të vetme). Kësaj radhe, me sa duket, ma ke dërgua këtë shkrim me nënvizime pa e publikuar në internet, për ndryshim nga pjesa e parë. Ti i ke thënë këto fjalë, ti i din më mirë këto punë. "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi" më duket Organizatë komplekse që ka pas persona me ide të ndryshme. Pos të tjerëve Ti e ke hisen tënde në këtë Organizatë, unë e kam timen dhe Jusufi e ka të veten. Individ të Organizatave tjera janë të kënaqur me Organizatat e veta e me ideologjitë e veta dhe kurrë nuk kishin dashtë për jetë me e ndërrua hisen e Organizatës së vetë me hisen Tënde të Organizatës Tënde, apo emrat e lavdishëm të Organizatave të veta me emrin e Organizatës Tënde.

Në një shkrim të mëparshëm, më duket se disa gjëra i ke thënë jo ashtu si duhet. Kam përshtypjen se ke dashtë me thënë se ne, disa më 1982 e kemi anashkalua OMLK.

Po ta lexosh librin e Mehmet Hajrizit do ta kuptosh se ata janë njerëz të zotët, zotë të historisë së Organizatës së vetë, që i din punët e veta vetë dhe nuk kanë nevojë për avokat. Megjithatë Ti i ke dhënë vetes të drejtë të flasësh për disa gjëra pa i marrë parasysh disa fakte, dhe je bazuar në informatat e dorës së katërt apo të pestë. Për këtë punë më ka ardhur keq, **më ka pas shkua mendja me reagua por nuk e bëra**.
Sidoqoftë unë të uroj shumë sukses në punën tënde. Shumë të fala, Xhafer Durmishi

-13. Letër nga Ramadan Pllana, 10 nëntor 2009

Shumë i nderuari Xhafer,

Unë të falenderoj për këtë letër elektronike! Unë nuk pretendoj të shkruaj krejt historikun e Organizatës sone dhe pa gabime, po atë që e di e atë që e kam pasë më afër. Nëse e ke përcjellë një reagim ndaj meje të Avdullah Prapashticës ku flet për bashkimin e dy organizatave ne Stamboll, ku ai thotë se erdhi në Shtutgart, ku ishe ti, e "shpëtoi" Organizatën sepse ishte në krizë nga mungesa e Jusufit....Vetëm Faredin Tafallari reagoi dhe ia mbylli gojën... Përsa i përket asaj që thua se mungonte OMLK, që e kam cekur unë, pas vdekjes së Kadri Gërvalles, atë e zëvendeson Xhafer Shatri më 15 maj në Zvicër, unë nuk e di se ishte dikush në bisedime në Stamboll, pas vrasjes së Kadri Zekës... Unë nuk kam qenë jashtë dhe nuk kam arsye morale për të shkruar, qoftë për të mirë, qoftë për kritikë... Shkrimin që e bëra për Metushin e kam hulumtuar shumë dhe ndiej mungesa sepse ashtu ishin marrëdhëniet në atë kohë e Sabriu na gënjente për shumë gjëra...Ti mundesh t'më shkruash për të gjitha gjerat që mendon se nuk janë reale. Sa për vazhdimësinë e LNçKJSH-së jashtë vendit unë mburrem, kur ishte Jusufi e ti në udhëheqësi, sa për te tjerat nuk kam pse mburrem... Me grupin e Deçanit, Komitetin Vendor, i kam pasë marrëdhëniet në superlativ dhe kam shkruar disa herë për ta... Sa për Sabriun, nëse ti mendon se ka bërë ndonjë mrekulli, më shkruaj, unë nuk e di, po gjërat duhet shkruar ashtu si kanë qenë, me anët pozitive e negative... Unë nuk kam asnjë vërejtje për librin tënd "Protesta e Aspirata" edhe pse mund të ketë gjëra që nuk më pëlqejnë... Ti i ke dhënë vetës të drejtë pa e konsultuar asnjë anëtar të Lëvizjes sonë, pse unë të konsultohem kur nuk kemi përputhshmëri në shumë aspekte! Nëse ti mendon se të kam anashkaluar gabon shumë sepse unë të respektoj shumë dhe **me sa të kam kuptuar ti vetë nuk ke dashur që të shkruash polemika** me ata që i shtrembërojnë të vërtetat, si Sabriu, p.sh....E përsëris se për rrjedhat e organizatës sonë në Gjermani, je ti kompetent, unë kurrsesi, prandaj të takon ty që ta mbrosh të vërtetën kur dikush e shtrembëron!

I nderuari Xhafer, duke besuar se më ke kuptuar drejt e pa keqkuptim, prano përshëndetjet e mia më të sinqerta, Ramadani

-14. Letër nga Xhafer Durmishi, 11 nëntor 2009

I nderuar Ramadan,

Të bashkangjitur e ke një letër time. E njejta për njoftim i dërgohet Faridin Tafallarit.

Shumë të fala, Xhafer Durmishi

Shumë i nderuari Ramadan, 11 nëntor 2009

Pjesën e dytë të shkrimit të Metushit ma kishe pas dërgua dje, më 10 nëntor 2009 në ora 09.00 para dite. Ditën kam qenë i zënë me disa punë dhe shkrimin e pash dhe ia hodha në sy shpejt e shpejt tek në mbrëmje. Dhe pas leximit të shpejt t'i shkruajta ata rreshta.

Fjalia ime "*Falemnderit për shkrimet që m'i ke dërguar me qëllim që të më informosh (dhe jo të kërkosh ndonjë mendim apo qoftë edhe një vërejtje të vetme)*.", e përdorur në letrën e djeshit nuk është aspak kritik ndaj teje por vetëm një precizim e sqarim pak për ty e më shumë për veten time. Nuk dihet se si sillen devret e dynjas. Për të evituar çdo keqkuptim, që nesër as ti e as ndokush tjetër të mos më thotë se këtë shkrim e kam pa në dorëshkrim para se të botohet dhe nuk kam dashtë me dhënë asnjë vërejtje çka do të thotë se mund të jem pajtuar me çdo fjalë. Vetëm evitimin e çdo keqkuptimi në këtë drejtim e ka për qëllim fjalia e cituar më lartë dhe asgjë tjetër.

Mua nuk më pëlqen roli i censorit për shkakun më të thjeshtë se edhe unë dikur jam marrë pak me shkrime dhe kurrë nuk kam durua censurues dhe as që do të duroja në të ardhmen.

Shkrimin e Abdullah Prapashticës e kam lexuar dhe ka shumë pak tekste që më bëjnë me qesh e që më kënaqin shpirtin më shumë se shkrimet e budallallëqet e Abdullah Prapashticës, dhe shpresoj që ai të vazhdoj me kontributin e tij teorik edhe më tutje. Zoti jetën ia shtoftë e i dhashtë shëndet. Është mirë që të ka ra ndërmend se ekziston Faridin Tafallari, si shok i Jusufit e njohës i mirë i rrethanave të asaj kohe. Për ekzistencën e Faridin Tafallarit e librit të tij "Terror Dhimbje Qëndresë" të kam tregua më 2006, ndërsa ti ishe i fokusuar më shumë dhe i kishe pas ra në trag Nuhi Sylejmanit e për Faridin Tafallarin nuk kishe ndie kurrë deri sa të tregova unë. Me fjalë tjera në këtë rast i ke shitë dardhagjisë dardha.

Citat nga letra jote:

"Përsa i përket asaj që thua se mungonte OMLK, që e kam cekur unë, pas vdekjes së Kadri Gërvalles, atë e zëvendeson Xhafer Shatri më 15 maj në Zvicer, unë nuk e di se ishte dikush në bisedime në Stamboll, pas vrasjes së Kadri Zekës."

Këtu e ke përdorë emrin Kadri Gërvalla. Kadri Gërvallën nuk e njoh, por me sa e di ky person është gjallë.

Ti përkundër një shkrimit tim, dukesh tepër i painformuar në disa pika. Ty dikush ta ka futë në tru mendimin se unë më 13 shkurt 1982, i paskna lënë fëmijët e Jusufit e të Bardhit nën kujdesin e Ibrahim Kelmendit e të ndonjë të afërmi të tij, se nuk paskna pasë unë në kokë mendim, gajle e mërzi tjetër dhe kam udhëtuar në Stamboll me qëllimin kryesor që ta di ku gjendet rezidenca e ish-inspektorit të UDB-së me komunistat e vetë, që të studioj 'platformat, iniciativat e ftesat e tyre.' Kjo është njëra anë e çështjes.

Ana tjetër ka të bëjë me atë se si me guxua unë e Sabriu me zhvillua bisedime me komunistat e Abdullahut pa qenë të pranishëm komunistat e OMLK. Sa qesharak është argumenti yt mund të duket nga vajtimet e Abdullah Prapashticës pse nuk ka mund me ra në kontakt direkt me komunistat e OMLK. Po të njejtën keqardhje e shprehë edhe Mehmet Hajrizi në librin e vetë dhe i akuzon komunistat e Abdullahit për mos dalje në takim. Pra Mehmeti, Hydajeti, Berat Luzha kanë qenë të lirë të takohen me kend kanë dashtë dhe Jusufi nuk është hatrua për këtë punë kurrë. Kadri Zeka e ka bërë një marrëveshje tepër të vockël me Ibrahim Kelmendin dhe Jusufi e as unë nuk jemi ndier të hatruar apo të anashkaluar.

Nuk kam kërkuar të konsultohesh me mua më parë dhe as nuk kërkoj tash. Më ka ardhur keq se më 17 mars 2009 nuk i ke marrë parasysh disa fakte historike, e të cilat i ke marrë parasysh dje më 10 nëntor 2009. E ke nënçmua punën e të tjerëve për të vetmin shkak se Ti vetë nuk ke qenë pjesëmarrës, jo për fajin Tënd. Eshtë absurde me u konsultua unë me Ty për gjëra që kanë ndodhë në Shtutgart, Stamboll, Biel-Bienne etj. kur Ti ke qenë në burg. Unë nuk e kam shkrua deri më sot asnjë rresht të vetëm për ngjarje që nuk kam qenë pjesëmarrës apo që nuk i kam dëgjuar direkt nga Jusufi e Bardhi. Por mos të harrojmë se ngjarjet e vitit 1981 e 1982 kanë qenë ngjarje që janë zhvilluar në një rreth qendror dhe kanë shumë interes edhe për ata që nuk kanë qenë pjesëmarrës, dhe ata që

nuk kanë qenë pjesëmarrës kanë 100% të drejta të barabarta sikurse pjesëmarrësit, të shkruajnë për to, t'i komentojnë, vlerësojnë, çmojnë, interpretojnë .... nënshkrimet e 17 shkurtit apo 15 majit 1982, krejt sipas nevojës dhe suksesit të çastit. Në disa raste këto projekte, sidomos të fundit janë dukur shumë të suksesshme fillimisht, por me kalimin e kohës shumë veta që kanë pështy në këto data e kanë lëpi atë që e kanë thënë.

Ke përmendë gjithashtu Xhafer Shatrin si zavendës të Kadri Zekës, e si përfaqësues të OMLK më 15 maj 1982. Duket se nuk e ke lexua historinë e OMLK të shkruar nga Mehmet Hajrizi. Me aq sa kam mund me e marrë vesh ata i kanë disa gjëra të vockëla, të pasqaruara në mes veti, si p.sh. kur është bërë bashkimi, çka është vendosur në te, dhe sa vlejnë nënshkrimet e 17 shkurtit 1982 apo të 15 majit 1982 për secilin person veç e veç. Besoj se kjo është çështje e tyre e brendshme dhe ata këtë punë do ta zgjedhin vetë pa ndërhyrjen Tënde apo timen. Kuptohet që unë nuk flas në emrin Tënd prandaj po të them se ata çështjet e veta të brendshme do t'i zgjidhin të paktën pa ndërhyrjen time. Kjo është edukata ime organizative që pos tjerash e kam mësuar edhe prej Jusufit. Xhafer Shatri nuk ka kërkuar që unë t'i sqaroj çështjet e tij me shokët e vetë të Kosovës e as të hyj në mes tyre. As unë nuk e kam kërkuar ndihmën e tij për t'u mbrojtur prej disa pohimeve Tua pjesërisht të pasakta e nënvlerësuese, apo të ndonjë tjetri.

Unë nuk jam i hidhëruar as prej teje as prej kujtdoqoftë për ndonjëfarë anashkalimi. Çdo kush që shkruan, mendoj se vëmendjen kryesore duhet t'ua kushtoj atyre shokëve që natyra nuk ua ka dhënë aftësitë, mundësitë apo mjetet për t'u shprehur me shkrim apo për t'a thënë fjalën e vetë përmes ndonjë masmediumi. Ti në intervistën e gjatë të marsit iu ke kushtua rëndësi personave për të cilët nuk ka folë kush më parë dhe kjo më duket shumë e mirë prej teje.

Ti ke shumë të drejt kur thua se unë nuk jam i interesuar për debate e për shkrime të ndryshme që botohen vazhdimisht. Puna e Jusufit dhe epokës së tij më intereson, mundohem me e përcjellë dhe gëzohem që përkundër shtrembërimeve vazhdimisht, herë një e herë një tjetër është duke e hedhur nga një cung të mirë në oxhakun e Flakës së Janarit.

Pasi e ke përmend Faridin Tafallarin, po kthehem pak tek ai si dhe tek intervista e Jote e marsit të këtij viti e botuar në albaniapress.com dhe pashtriku.org. Disa thënie tua:

"*Nga analizat dhe shoshitjet e mia që ia kam bërë këtij udhëtimi në Stamboll, qysh nga qëndrimi në Turqi, pastaj në burg, në mërgatë dhe në biseda me shokë kam konstatuar se shkuarja ime në Stamboll, ishte një komplot i kurdisur i disa personave zyrtarë, si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri, që ishin kundër ribashkimit të Kosovës me Shqipërinë, në krye të të cilit, me gjasë, qëndronte diplomati i shtetit shqiptar Bujar Hoxha."*

"Aty, pas një kohe, afërsisht rreth orës15, erdhën dy persona të cilët Tefiku m'i prezentoi si diplomatë të shtetit shqiptar, me gjasë Bujar Hoxha dhe një tjetër me të cilët pata një polemikë të ashpër lidhur me ndryshimin e pikës së parë të Statutit tonë, d.m.th. të hiqnim dorë nga ribashkimi me Shqipërinë."

Faridin Tafallari, shok i ngushtë i Jusufit ka folë me të bijën e Bujar Hoxhës (emrin të bijës së Bujarit nuk ia di) dhe ajo i ka thënë se baba i saj Bujar Hoxha ka qenë me shërbim si diplomat në Turqi nga qershori 1981 gjer në tetor 1982. Titulli i tij ka qenë: "Ministër fuqiplotë i Shqipërisë në Ankara". Ti nuk e ke takuar Bujar Hoxhën as me gjasë e as pa gjasë, dhe e ke munduar njeriun pa hak. Është mirë që këtë gabim ta ndreqësh vetë para se me ta ndreq të tjerët. Kam frikë se sulmimi i një personi që nuk e ke takue e dëmton besueshmërinë Tënde deri në njëfarë mase. Citat tjetër i Yti:

"- LPRK-ja, më vonë LPK-ja, si vazhdimësi e Lëvizjes gjithëpopullore, në udhëheqësinë e vet, kishte anëtarët më konsekuentë të OMLK-së, LNÇKVSHJ-së, e të

shumë grupeve të tjera, që kishin vepruar pa u ndalë kundër okupatorit serbo-sllav. Mirëpo, De facto: LNÇKVSHJ-ja, u shua si subjekt me vrasjen e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe të Kadri Zekës. Praktikisht, me vrasjen e Jusufit dhe Kadriut, të cilët ishin pionierët e bashkimit të mirëfilltë të të gjitha organizatave patriotike në Kosovë dhe në viset tjera të ish RSFJ-së, do të zbehet edhe aktiviteti organizativ, që do të zgjatë deri në lirimin e të dënuarve të ndërgjegjes kombëtare, sidomos të atyre, që u gjykuan për organizimin e demonstratave të vitit 1981. Kurse, De jure: Aktiviteti i LNÇKVSHJ-së u shua një muaj pas atentatit makabër që u bë në Shtutgart më 17 janar të vitit 1982. Pra, një muaj, pas rënies heroike të dëshmorëve të lartpërmendur, më 17 shkurt të vitit 1982.Në Turqi, Sabri Novosella, në emër të LNÇKVSHJ-së, dhe Abdullah Prapashtica, në emër të PKMLSHJ-së, pa e përfillur OMLK-në, me të cilën, Jusufi e Kadriu, i kishin bashkuar aktivitetet nga viti '81, në prezencën paternaliste të diplomatit të shtetit shqiptar në Turqi, Bujar Hoxhës, - shpallin të formuar Lëvizjen për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi (LRSSHJ). Zvicër, Më 17 Mars, 2009"

(Këtu në letrën origjinale është një fotografi e Zërit të Kosovës mars 1982 të cilën e hoqa në mënyrë që të mos kesh pengesa me e qelë këtë shkrim-Xh. D.)

Ky numër gazete me këtë titull, "Zërit i Kosovës", në emër të cilës Organizatë ka dalë? Kur ka dalë ky numër i gazetës me citatin e Jusufit? Kisha me qenë shumë i kënaqun nëse din me u përgjegj në këto pyetje, kush e qiti, apo mos piku nga qielli?! Në mos askush tjetër Ibrahim Kelmendi mundet me të tregua. Krahasoje këtë titull gazete me fjalët që ke thënë më 17 mars 2009. Edhe njëra edhe tjetra nuk munden me qen të vërteta.

Historinë apo hisen Tënde të historisë nuk e njoh mirë dhe me te ke të drejtë të bësh çfarë të duash. As historinë e Sabriut nuk e njoh sa duhet, por unë jam i kënaqur që e njoh shumë mirë historinë e Jusufit, dhe kjo, jo vetëm që më mjafton por Ti nuk mundesh me e marrë me mend se sa më tepron. Unë nuk jam i interesuar të dukem e të debatoj pa më shty zori. Më pëlqen jeta e heshtur, anonime dhe e qetë në qytezën ku jetoj. Nuk i them askujt, as nuk kam bërë marrëveshje as gojore e as me shkrim me askend që të mos u bëjë vërejtje apo sulmoj me cilin intensitet të don shkrimet që i ka shkrua dora ime. Atë princip që e aplikoj ndaj vetes e aplikoj edhe ndaj të tjerëve.

Shumë të fala, Xhafer Durmishi

-15. Letër nga Ramadan Pllana, 12 nëntor 2009

Përshëndetje Xhafer!, I nderuari Xhafer,

E mora një letrën të gjatë nga ti e cila më befasoi për shumë gjëra, e para se ti e përmend cenzurën, kundër të cilës jam edhe unë, sipas kësaj kuptohet se unë të cenzuruakam ty... Gabim ose keqkuptim, si të duash merre! Unë po mundohem që t'i ndriçoj ngjarjet dhe personalitetet e Lëvizjes sonë, aq sa mundem, ti mund t'më ndihmosh nëse do, e di se mundesh, sidomos për ngjarjet në Stamboll e në Shtutgart, unë e ndiej vehtën të paaftë në këto dy ngjarje, sa për kureshtje i kam lexuar edhe shkrimet tua në lidhje me ketë dhe të besoj , më shumë se Sabriut e Abdullahut...Ti pse mundohesh të më cenzurosh, si Abdullah Prapashtica duke me thëne se nuk i di gjërat! Si pikë e parë, sipas bindjes sime të mbrendshme, unë nuk e marrë vehtën si kompetent për shkrimet që i bëjë, njerëzore është nëse gaboj dikund dikund, po qëllimin e kam që ta ndriçojë historikun e Lëvizjes sonë me aq sa mundem... Për këtë edhe kam përgëzime e mirënjohje nga disa shokë. Pika e dytë, unë kam bërë një lëshim, nuk e kam kontrolluar, kur e kam shkruar Kadri Gërvalla, që në realitet duhej të ishte Kadriu dhe vëllezërit Gërvalla. Pika e tretë, unë kam qenë i interesuar që t'i njihja të gjithë shokët e Jusuf Gërvallës, kurse për Nuhi Sylejmanin as që kam kërkuar ta njoh, vetëm kam pyetur për te, sepse së paku deri më tani kam qenë 15 herë ne Shtutgart. Pika e katërt, Për Faredin Tafallarin kam respekt

sepse është i vetmi që e mbron Jusufin nga shtrembimet që ia bëjnë Sabriu e Abdullahu... Sa për Bujar Hoxhën, unë jam informuar se ai ka jetuar në Stamboll, edhe pa qenë konsull i shtetit amë, ti nuk mundesh të më bindësh se nuk ka qenë ai...Pika e pestë, ti e ke njohur Jusufin më për së afërmi dhe ty të takon që ta mbrosh nga të tjerët, nga Ibrahimi e Abdullahu, kur mundohen që ta bëjnë të vetin, unë kam shkruar për Jusufin disa herë, do t'isha shumë i kënaqur dhe mirënjohës nëse shkruan ende për te, nuk mjafton vetëm ta ruajsh kujtimin e mos të reagosh kur te tjeret e shtrembojnë personalitetin e tij. Pika pestë, unë kur e kam përmend citatin e Jusufit në "Zërin e Kosovës" apo në "Lajmëtarin e Lirisë" kam pasë qëllim që ta mohoj zërin e atyre që thonë se Jusufi nuk e donte Shqipërinë socialiste, sa për ilustrimin e "Zërit të Kosovës" tani në "Albaniapress" nuk e kam zgjedhur unë, redaktorët e kanë vënë sipas dëshirës së tyre.

I nderuari Xhafer, nëse nuk do të ballafaqohesh me shtrembimet e të tjerëve që i bëjnë Lëvizjes sonë, Sabriut, Abdullahut e të tjerëve, është puna jote, unë nuk do t'i lë që ta shtrembojnë të vërtetën. Mua pse po më gjuhësh me pa të drejtë, unë në asnjë rast nuk kam shkruar kundër teje!....

Gjithë të mirat e **pa trazime**, Ramadani

(Letra e fundit e R. Pllanës - Këtë fakt po e potencoj jo për ta vajtue përfundimin e korrespondencës me te por për demantimin e të pavërtetës së tij, në mesin e shumë të tjerave se unë e paskna ndërpre i pari kontaktin).

-16. Letër nga Xhafer Durmishi, 12 nëntor 2009

Shumë i nderuari Ramadan, 12 nëntor 2009

Të falenderoj për letrën e fundit (të sotit të orës së parë pas mesnate). Më vjen mirë që në letrën time të djeshit t'i kam thënë disa mendime lidhur me disa qëndrime tuajat që kanë të bëjnë me intervistën Tënde të 17 marsit 2009 dhe sidomos me fundin e kësaj interviste. Aty nuk është fjala për mungesë informatash por për qëndrime ndaj ngjarjeve e fakteve që dihen prej të gjithë të interesuarve. Si i sheh ti shumë ngjarje, e ke thënë në mënyrën tënde të shkëlqyeshme dhe pa asnjë dilemë në këtë intervistë, me gjuhën shkencore e intelektuale, me de facto e me de jure, e me ka krejt. Ti nuk mundesh të thënën me e bërë të pathënë. Neve nuk na ka ra të veprojmë së bashku e as të shkëmbejmë mendime para këtyre letrave të fundit. Ti prej anës time gjithmonë ke qenë, je dhe ke me mbet i lirë të thuash çfarë të duash për Lëvizjen Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve tjera shqiptare në Jugosllavi edhe për periudhën 1978-1982, e sidomos, sidomos për hisen Tënde.

Ti thua se ndonjë gabim mund të të jetë përvjedhur për shkak të mungesës së informatave, dhe mendon se unë mundem me të ndihmua në këtë pikë. Unë nuk mundem, por çka është edhe më kryesorja, ndihma ime është krejtësisht e panevojshme, pasi shumica e fakteve gjenden të shkruara në libra për mrekulli. Në këtë kuptim mund të them se Amerika është zbuluar dhe ata që mendojnë se e zbulojnë vazhdimisht, nuk merren seriozisht. Librin "Fati i luleve", të Kadri Rexhës, të vitit 1993 duhet ta kesh. Librin "Terror, Dhimbje, Qëndresë" të Faridin Tafallarit të vitit 1997, për të cilin të kam folë në fund të 2006-tës, mundesh me e sigurua pasi adresën elektronike të Faridinit e ke.

Me këto fjalë, diskutimin tonë privat **në këtë çështje** e konsideroj të mbyllur prej anës time. Unë nuk kam çka të shtoj shumë pos asaj që kam thënë në shkrimet e mëparshme. Unë nuk jam i interesuar për debate e as të lodhem shumë se kush lufton për

përvetësimin e Jusufit. Kjo vetëm tregon për madhështinë e jashtëzakonshme e unike të Jusufit, dhe ky fakt është ai që mua më kënaq më së shumti.

Të uroj sukses në të gjitha punët tuaja.

Shumë të fala, Xhafer Durmishi

-17. Letër nga Xhafer Durmishi, 29 nëntor 2009

I nderuari Ramadan,

Apostol Duka, në janar të këtij viti (2009) ka botuar një biografi për Kadri Zekën. Ky libër më erdhi nga Kosova verën e këtij viti. Në te ka mjaftë gjëra interesante, por më së shumti përshtypje më kanë lënë rreshtat e mëposhtëm që po t'i dërgoj:

Apostol Duka: - Kur janë vrarë Isufi, Kadriu e Bardhi edhe në Shqipëri kishte ngjarje tragjike. Vriste veten Mehmet Shehu, pak më vonë arrestoheshin Fiqrete Shehu me të dy djemtë e saj, pasi i madhi vrau gjithashtu veten, si dhe Kadri Hazbiu dhe Feçorr Shehu. Në atë kohë vrasja e heronjve të Kosovës lidhej pikërisht me këto ngjarje tragjike. Thuhet se madje ishin tradhtuar prej andej dhe se ai dorasi i famshëm që përmend baca Taip ishte shqiptar nga Kosova. Keni juve ndonjë koment për këtë?

Shaip Zeka: -Unë për veti dhe na si familje Zeka nuk dim gja se ka pasun dorë nga Shqipëria. Ne dim vetëm që i ka vra UDB-ja dhe kaq. f.27

Adem Dema-Demaçi **për lidhjen e tij me Jusufin**

Adem Dema-Demaçi: Unë nuk kam qenë kurrë as enverist, as komunist. f.150

A. Duka: Por ajo që doja të thosha është se vëllezërit e Kadri Zekës flisnin me një nderim të veçantë për juve. Ata nuk e quanin veprimtarinë tuaj ilegale as revolucionare, as marksiste-leniniste, por thjesht atdhetare.

Dema: Unë nuk kam qenë as enverist ose komunist. 154

A. Duka:- I keni njohur në atë kohë Jusuf Gërvallën dhe Kadri Zekën?

A. Dema: Jusufin e kam njohur pas daljes nga burgu i parë. Ai ka qenë i lidhur me ne... Jusuf Gërvalla ka mbetur i pazbuluar. Kanë mbetur edhe grupe të pazbuluara, sepse ne bënim ç'është e mundur të ruanim konspiracionin. I tillë ka qenë edhe ai i Jusufit. Jusufin e kam njohur, Bardhin e kam njohur, ndërsa Kadri Zekën jo. f.156

Apostol Duka: - Mbrëmë, Hydajet Hyseni dhe Berat Luzha u befasuan kur unë iu thashë se ekzekutorët, ose dorasit, siç quhen në Kosovë dhe në veri të Shqipërisë, e Kadri Zekës dhe të vëllezërve Gërvalla kanë qenë shqiptarë, djem të familjeve kosovare që banonin prej kohësh në Shqipëri. Sigurisht ata kanë qenë në shërbim të UDB-së jugosllave, të paguar e të urdhëruar prej saj. E keni ditur ju këtë fakt?

M. Hajrizi: Si përfundim, nuk do të më duket aspak befasuese nëqoftëse një ditë do të verifikohet se Kadri Zeka dhe Jusuf e Bardhosh Gërvalla janë vrarë nga dora e shqiptarëve. f.183

Apostol Duka: -Kjo është zbuluar tashmë. Vetëm se nuk është bërë publike, por juve me pozitën dhe me njohjet zyrtare që kini në Shqipëri, mund të kërkoni dhe të merrni një informacion më të hollësishëm.

Berat Luzha: -Me sa mbaj mend, është fjala për të njejtët persona që përmend edhe Ibrahim Kelmendi, me mbiemrat V..., G..., R... f. 184

H. Hyseni: -Patjetër që mund të vazhdojmë. Veçse për punën e librit këmbëngul që duhet të jemi shumë të kujdesshëm, sepse ai njëherë shkruhet. f. 189

A. Duka: Pak kohë para se në Shtutgart të ish-Gjermanisë Federale të vriteshin Kadri Zeka dhe vëllezërit Gërvalla, në Shqipëri vrau veten në kushte edhe sot të dyshimta

e të pasqaruara Mehmet Shehu... Pak kohë pas vrasjes së Kadri Zekës dhe vëllezërve Gërvalla, arrestohet Kadri Hazbiu... por edhe të tjerë, të akuzuar, gjykuar e dënuar shumë rënd kohë më parë si Beqir Balluku, Petrit Dume, Hito Çako, Koço Theodhosi, Kiço Ngjela e të tjerë. ... në Shqipëri qarkulloi fjala sikur informacionin për Kadri Zekën dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallën, shërbimet e fshehta serbe e kishin marrë pikërisht nga Shqipëria. Sipas asaj fjale apo thashethemnaje, kjo ka ndodhur pas një takimi të disa prej drejtuesve të OMLK në njërën prej ambasadave tona, ndoshta në Bullgari ose në Austri. Ata të ambasadës pastaj kanë raportuar për takimin në ministrinë e Brendshme dhe në atë të Jashtme, fjala ka shkuar në veshët e Feçorr Shehut e Nesti Nases dhe këtu është mbyllur rrethi: Këta të fundit kanë raportuar menjëherë tek padronët e tyre në Beograd për anëtarët më kryesor të organizatës, emrat, vendndodhjet, detyrat që kryenin, veprimtarinë që zhvillonin etj. Ju e dini mirë se OMLK është goditur rëndë tamam në këtë kohë, jo vetëm me vrasjen e Shtutgartit, por edhe me arrestimet e shumta dhe dënimet e rënda të drejtuesve të saj.

Shihni ju të dy (Hydajet Hyseni e Berat Luzha-shën. im) ndonjë të vërtetë a ndonjë lidhje mes këtyre ngjarjeve të rënda, mund të ketë ndodhur tamam kështu siç është folur?" f. 201

Të fala, Xhafer Durmishi

-18. Letër nga Xhafer Durmishi, 7 dhjetor 2009

I nderuari Ramadan,

pashtriku.org e ka botuar sot Ditarin e Jusufit (është fjala për 8 faqe A4). Besoj se në faqen e pashtrikut, ai i ka zvogëlua që të mos i zen shumë vend. Po ta dërgoj dorëshkrimin që është i kualitetit më të lartë.

Të fala, Xhaferi

5. Jusuf Gërvalla - Bibliografi aktuale

Në këtë bibliografi janë përfshi punime jo vetëm nga ato që kanë të bëjnë direkt me Jusuf Gërvallën, por edhe ato kur për te flitet në mënyrë indirekte. Nuk pretendoj se kjo bibliografi është e plotë. Këtu kam zgjedhur ato shkrime të cilat kam pasur rastin t'i lexoj.

Bajram Sefaj; Shkurt Poezi!
Përmbledhja e parë e poezive të Jusuf Gërvallës "Fluturojnë e bien" në botim të NGB "Rilindja" nga Prishtina, u pranua ngrohtë te numri më i gjerë i lexuesve
("Flaka e vëllazërimit", Shkup, 21 shtator 1973, f.11)

Me sa dihet ky shkrim i Bajram Sefajt është komentimi i parë i poezisë së Jusufit. Megjithatë këtu, jo për fajin tim, kemi të bëjmë me mungesë sqarimesh, apo me një anakronizëm. Në bazë të të dhënave, përmbledhja me poezi "Fluturojnë e bien" është botuar në vitin 1975, ndërsa shkrimi i Bajram Sefajt mban datën 21 shtator 1973!?

Sylejman Syla; Poezi shfryrjesh të sinqerta, (Fjala, nr. 4, 1976, Prishtinë, f. 5)

Ali Aliu; Dy poetë që vijnë, Gazeta "Flaka e vëllazërimit", Shkup, - 6 qershor 1976, f. 17

Agim Morina dhe Shaip Beqiri; Intervistë me Jusuf Gërvallën,

Pikë në horizont që s'do të mbetet vetëm pikë, Bota e re , 1 prill 1977

Shaip Beqiri; Duke kërkuar qeshjen e një poezie, "Zëri i rinisë", Prishtinë, 21 tetor 1978, f. 11-14

Halit Fetahu; Vokacione poetike të frymëzuara nga qenësia jonë
(Jusuf Gërvalla, Kanjushë e verdhë, botoi "Rilindja", Prishtinë, 1978)
"Bota e re", Prishtinë, 1978

Sabri Maxhuni-Novosella; Vëlla i dhembjes krenare, (poezi kushtuar Jusuf Gërvallës), Adapazar-Turqi 1982

Stuttgarter Zeitung; U VRANË TRE EMIGRANTË JUGOSLLAVË, 19 janar 1982

Stuttgarter Nachrichten; HEILBRONN: TRE REFUGJATË JUGOSLLAVË U VRANË NATËN E KALUAR, 19 janar 1982

Enver Hadri; Ja vdekje, Ja liri!, Zëri i Kosovës, Bruksel, 20 janar 1982, Gjendet edhe në librin nga Halit Elshani: "Çeta e Brukselit", kapitulli 34, f.154 Prishtinë 2007

Stuttgarter Nachrichten; SULM TERRORIST NË HEILBRONN, 20 janar 1982
Bild Zeitung; DHUNA, 20 janar 1982

Gazeta e Shtutgartit; TERROR POLITIK, janar 1982
Horst Zimmermann; DORA E GJATË E BEOGRADIT SHTRIHET DERI NË REPUBLIKËN FEDERALE, Heilbronner Nachrichten, 21 janar 1982

Xhafer Durmishi; Emrat tuaj flamuj në beteja, fjalim i demonstratës së 23 janarit 1982 në Shtutgart, Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 8

Der Spiegel; E tëra dukej si pas një ekzekutimi, 25 janar 1982

Südwestdeutsche Zeitung; NJOHURI MBI VRASJEN E JUGOSLLAVËVE, 30 janar 1982

Xhafer Durmishi; "Ju u bëtë pronë e brezave", fjalim që u lexua me rastin e varrimit, më 5 shkurt 1982, i shkruar nga Xhafer Durmishi dhe lexuar nga Remzi Ademi. Përveç këtij fjalimi janë lexuar edhe 4-5 fjalime tjera; nga Agron Sela, Fazli Memaj, aktivist gjerman e turq, por fjalimi "Ju u bëtë pronë e brezave" është i vetmi që është botuar e ribotuar disa herë, deri më sot. (Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 7-8)

Xhafer Durmishi; Nekrologji, shkurt 1982, Zëri i Kosovës, mars 1982, faqe 2

Xhafer Durmishi; Kush e vrau Jusuf Gërvallën?, shkurt 1982, trakt i shpërndarë në shkurt 1982 në emrin e punëtorëve të rrethit të Shtutgartit. (I ribotuar në librin e Faridin Tafallarit, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 362-363 dhe www.pashtriku.org)

Xhafer Durmishi; "Tre ranë, me mijëra u ngritën" (kryeartikull i Zërit të Kosovës, mars 1982)

Jusuf Gërvalla; Rrotull, roman, Shtëpia Botuese Naim Frashëri, Tiranë, 1983

Xhafer Durmishi; Përherë i freskët do të jetë kujtimi për ju dhe ata si ju (Kryeartikull, Zëri i Kosovës, janar 1985, Suedi)
Në këtë artikull për herë të para lidhet Oksigjeni i 17 janari 1468 me Flakën e 17 janarit 1982. Për herë të parë bëhet **Lidhja e Lezhës me Untergruppenbachun.**

Ismail Kadare; Baladë për vdekjen e Jusuf Gërvallës, Koha, 24 tetor 1990

Ndoc Papleka; Vrasja e poetit, Zëri, 26 nëntor 1990, Prishtinë,

Prend Buzhala; Mesazhet e Janarit, Janar 1991, ribotuar te "Iliria Post", 20 janar 2007, fq. 20

Riza Bicaj; Jusufin e kisha nxënës dhe shok pune, Zëri, 18 janar 1992

Teki Dervishi; Dy Jusuf Gërvalla, Zëri, Prishtinë, 18 janar 1992, f.45

Mehmet Kraja; Midis idealit politik dhe vokacionit krijues, Fjala, qershor 1992, f. 11

Haqif Mulliqi; Porosi universale për lirinë,
Procesi, dramë e Jusuf Gërvallës, botoi Zëri i Kosovës, 1984, Bujku, Prishtinë, e shtunë 26 qershor 1992, f. 7

Jusuf Gërvalla; Vepra letrare, Ora, Prishtinë 1992

Sabri Hamiti; Drama "Procesi", Prishtinë, Kallnor 1992, Nga shkrimi "Bisedë me Jusufin - fragment" i Sabri Hamitit në Rilindja, 19 janar 2002, f. 20-21

Berat Luzha; Si u krijua Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, Zëri, 18 janar 1992

Sabri Novosella; Si e formuam Lëvizjen për Republikën Shqiptare në Jugosllavi, Zëri, mars 1992

Xhafer Durmishi; Organizatat politike shqiptare në Evropë 1979-1985, maj 1992

Kadri Rexha; Fati i luleve, Rruga jetësore e shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Gërvalla, Buzuku, Shkup 1993
Ka disa libra të botuar ku figurë qendrore është Jusufi. Megjithatë deri më sot, Kadri Rexha është i vetmi që e ka shkruar një libër të tërë për jetën e Jusufit. Ana e fortë e këtij libri është përshkrimi i veprës së Jusufit në Kosovë. Sa i përket veprimtarisë në mërgim, Faridin Tafallari ka dhënë detaje të rëndësishme në ndriçimin e disa aspekteve të veprimtarisë së Jusuf Gërvallës.

==========

Kadri Rexha -Shkrime për Jusuf Gërvallën
I. Shkrime për Jusuf Gërvallën:

1. Kadri Rexha: *Ende ka njerëz* (Çast me poezinë e Jusuf Gërvallës "Ka akoma poet",

botuar në vëllimin poetik "Fluturojnë e bien", Rilindja, Prishtinë, 1975) "Flaka e vëllazërimit", 2 qershor 1977 dhe "Rilindja", 17qershor 1978
2. Kadri Rexha: *Këngët e mia janë zë i butë i fushës...* (Prologomenë e imagjinuar e poetit Jusuf Gërvalla për lirikat e tij të botuara në vëllimet "Fluturojnë e bien", 1975 dhe "Kanjushë e verdhë", 1978, të botuara nga "Rilindja", Prishtinë) "Rilindja", 15 shtator 1979
3. Kadri Rexha: *Zëri i populli të vet* (me rastin e 45-vjetorit të lindjes së Jusuf Gërvallës), „Demokracia“, Zyrih, Nëntor 1990, fq.5; I njëjti artikull i botuar në „Dëshira“, numër i posaçëm, Malmë, Janar 1991, fq.1-2
4. Kadri Rexha: *Fati tragjik i kthyer në qëndresë* (portret i vogël për figurën madhore të Nënës Ajshe – kushtuar nënave kosovare), „Alternativa“, nr.5, Lubjanë, 29 shtator 1990, fq.5;
5. Kadri Rexha: *Fati i atdhetarit* (me rastin e 45-vjetorit të lindjes së Jusuf Gërvallës), „Alternativa“, nr. 9-12, Lubjanë, 1990, fq. 145-153;
6. Kadri Rexha: *Në lindjen e trimit (*Fragment nga monografia për Jusuf Gërvallën), „Qëndresa“ , nr. 9, Zyrih, Shtator 1991, fq. 8-9;
7. Kadri Rexha: *Rrugës letrare të Jusuf Gërvallës* (në 10-vjetorin e vrasjes së Poetit), „Fjala“, nr.2, Prishtinë, Janar 1992, fq. Fq.9;
8. Kadri Rexha: *Arratisja e Jusuf Gërvallës* (në 47-vjetorin e lindjes së Poetit), „Rilindja“, Zyrih, 23 dhjetor 1992, fq. 8;
9. Kadri Rexha: *Edukimi dhe formimi i personaliteti të Jusuf Gërvallës*, „Bota shqiptare“, nr.6, Zyrih, Tiranë, Qershor 1993, fq. 6-8;
10. Kadri Rexha: *Rruga e mërgimit nuk merret nga dëshira*, intervistë me mr. Kadri Rexha, intervistoi Shefqet Dibrani, „Qëndresa“, nr.8/9, janar-shkurt 1994, fq. 13-17
11. Kadri Rexha: *Mendjelehtësi apo diçka tjetër* (lidhur me artikullin "Katër rrëfime për Jusuf Gërvallën", të nënshkruara nga Focusipress, botuar në gazetën "Focusi", nr 10, datë 17 janar 2004, faqe 3-7), "Focusi", botim jashgtë atdheut, 7 shkurt 2004, dhe pas një muaji në "Epoka e re" dhe në "Focusi", të Prishtinës
12. Kadri Rexha: *Jusuf Gërvalla – emër që u bë traditë* (në 50-vjetorin e lindjes së Jusufu Gërvallës), „Zëri i Kosovës“, nr.20, Zyrih, 15 tetor 1995, fq.8; I njëjti artikull i plotësuar i botuar në librin „Heroi me kitarë“ (sesion i zgjeruar shkencor), Përgatiti: Rasim Selmanaj, Focus“, Prishtinë, 2007, fq.174-178;
13. Kadri Rexha: *Jusufi ishte në ballë të forcave të progresit historik* (në 60-vjetorin e lindjes së Jusuf Gërvallës, intervistë me Kadri Rexhën, bashkëpunëtorin dhe jetëshkruesin e Jusufit, intervistoi Lulëzim Etemaj, “Epoka e re”, Prishtinë, Tetor 2005. E njëjta intervistë e botuar në librin “Heroi me kitarë” (sesion i zgjeruar shkencor), Përgatiti: Rasim Selmanaj, “Fokus”, Prishtinë, 2007, fq. 377- 392; Kadri Rexha, Thirrjet e kohës, RKL, Prishtinë, 2014

Shkrime për librin "Fati i luleve" të Kadri Rexhës
II.Shkrime për librin "Fati i luleve":
1. Ramadan Musliu: *"Fati i luleve"* (Rruga jetësore e shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Gërvalla), “Rilindja”, (CH), 7 shtator 1993
2. Faik Racaj: *"Fati i luleve"* (kushtuar patriotit të madh Jusuf Gërvallës) i autorit Kadri Rexha, “Zeri i Kosovës”, (CH),15 janar 1994
3. Rushit Ramabaja: *Baladë për kanjushën e verdhë*, Kadri Rexha, "Fati i luleve", botoi “Gjon Buzuku”, Prishtinë, 1993, “Rilindja” (CH), 28 janar 1994, fq.9; dhe “Bujku”, Prishtinë, 29 janar 1994, fq.6
4.Kadri Rexha*: Rruga e mërgimit nuk merret nga dëshira,* intervistë me mr. Kadri Rexha, intervistoi Shefqet Dibrani, „Qëndresa“, nr.8/9, janar-shkurt 1994, fq. 13-17

5. Kadrush Radogoshi: *Sfida e heroit* (Për librin e Kadri Rexhës „Fati i luleve), „Rilindja“ (ZH), 14 maj 1994, fq.9 ; „Bujku“ (besoj e njëjta datë)
6. Kadrush Radogoshi: *Monografi për jetën dhe vdekjen vertikale*, Kadri Rexha: „Fati i luleve“, Buzuku, Prishtinë, 1993, "Nëpër universin letrar", „Rilindja“, Prishtinë, 2003, fq. 143-150
7. Izet Duraku: *Fati i luleve*, (vështrim), „Luma“, Kukës, 1994
8. Koço Danaj: *Homazh tribunit të popullit Jusuf Gërvalla* (Mendime rreth librrit: „Fati i luleve“ të shkrimtarit Kadri Rexha), „Zëri i Kosovës“ (CH), nr. 22, 15 Nëntor 1994; dhe me shkurtime në „Illyria“ (USA), 19-21 janar 1995, fq. 17
9. Ferhat Cakaj: *Liria do të vijë*, shënime për monografinë “Fati luleve” të Kadri Rexhës, “Rilindja” (CH), 17 janar 1995, fq.12 dhe në “Rilindja”, botim i Tiranës, (besoj e njëjta datë)
10. Hasan Bunjaku: *Orë e madhe letrare*, Tribuna për veprën e Kadri Rexhës “Fati i luleve”, në kuadër të manifestimit tradicional “Flaka e Janarit ‘95”, “Rilindja”, 20 janar 1995
11. Sabit Rrustemi: *Një fat i njëjtë me lulet* (Kadri Rexha: Fati i luleve” (monografi) botoi “Buzuku”, Prishtinë, 1993, “Bota sot”, 23 janar 1996, fq.9
12. Hasan Ukëhaxhaj: *Kontribut i çmuar për ndriçimin e veprimtarisë kombëtare të dëshmorëve të Kosovës*, Kadri Rexha, Pushkë lajmëtare, monografi kushtuar dëshmorit Edmond Hoxha, (pasthënie e librit), Epoka e re, Prishtinë, 2002
13. Shefqet Dibrani: *Fati i luleve dhe mërgimi i heroit*, Kadri Rexha: “Fati i luleve – Rruga jetësore e shkrimtarit dhe atdhetarit Jusuf Gërvalla”, moografi, botoi NB “Gjon Buzuku”, Prishtinë, 1993, fq.240, ISBN 86-7785-012-0, (shkruar në Janar 1994), në librin “Libra dhe mbresa” (venerime letrare), albanisches institut, ST. Gallen, 2005, fq.57-60
14. Ahmet Qeriqi: *“Fati i luleve”, një vepër monumentale për jetën dhe veprën e Jusuf Gërvallës,* shkruar nga bashkëveprimtari, Kadri Rexha, Radio „Kosova e lirë“, 22 maj 2008
15. Halit Bogaj: *"Kadri Rexha: Fati i luleve",* me rastin e 30-vjetorit të vrasjes së Jusuf Gërvallës, Zemra shqiptare, 19.01.2012

==========

Shaban Sinani; Një ëndërr e vrarë, një tërmet i ndërprerë, 1996, Heroi me Kitarë, f. 65-69

Sabri Hamiti; Misioni, Dramë në katër kohë, Rilindja, Prishtinë 1997
Kjo dramë është një nga punimet më të dobëta, fyese e denigruese për personin e Jusufit. Siç vërehet nga kjo vepër Sabri Hamiti nuk ka lindur me dhuntinë që të kap apo të ketë rezonancë të njejtë me spektrin e ndjenjave të Jusufit. Por kjo dramë nuk bënë fjalë vetëm për Jusufin, sepse në te përshkruhen edhe disa momente jetësore të Suzanës (gruas), Premtonit (djalit) dhe Donikës (bijës) së Jusufit. Kush don të dij për një pjesë të ideve të Suzanës, Premtonit e Donikës, vepër më të mirë nuk mundet me gjetë.

Skënder Blakaj;Një fjalë për Jusufin, Me rastin e 15 vjetorin e vdekjes së Jusuf Gërvallës, 1997

Sabri Novosella; Intervistë Haqif Mulliqit, Zëri 1997

Shefqet Jashari-Strofci; Intervistë me Shefqet Jasharin, anëtarin e Komitetit Qendror të

Lëvizjes Nacionaçlirimtare të Kosovës dhe viseve shqiptare nën Jugosllavi (LNÇKVSHJ), Drita, Trelleborg-Suedi, nr. 15, 1997

Faridin Tafallari; Terror–Dhimbje–Qëndresë, EURORILINDJA, Tiranë 1997
Ky libër përbëhet prej dy pjesëve. Kujtimet e Faridin Tafallarit prej vendosjes së tij në Gjermani më 1973 deri në vitin 1995 dhe pjesën e dytë, dokumente e letërkëmbime të tijat dhe të aktivistëve tjerë. Personazhi kryesor i kujtimeve të veta kuptohet vetvetiu se është vetë Faridin Tafallari. Për Jusufin në mënyrë direkte nuk shkruhet në shumë faqe. Megjithatë, ajo që shkruhet për Jusufin është shumë interesante. Fakte më të mira për veprimtarinë e Jusufit në Gjermani deri më sot nuk ka sjell askush. Ajo çka vlen për t'u përmend është se ky libër çmohet e vlerësohet në superlativ pos tjerësh, nga Xhafer Shatri dhe Hasan Mala.
Dokumentet e botuara e të ruajtura i japin Faridin Tafallarit një meritë të veçantë për kujdesin ndaj arkivimit dhe publikimit të historisë së Jusufit, Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi dhe disa organizatave tjera.

Fardin Tafallari; Dhimbje Krenare, Lilo, 1998
Ky libër ka disa përsëritje nga i lartpërmenduri, por nuk i afrohet të parit. Ana e fortë e këtij libri është se për herë të parë botohen dokumente (letra) të Jusufit dhe të tjerëve që hedhin dritë për veprimtarinë e viteve 1980-1982.

Kadrush Sylejmani; Metush Krasniqi, Botues: Autori, Prishtinë 1999
Libër i dobët dhe i ngarkuar me eklektizma. Në te përmendet disa herë Jusuf Gërvalla dhe në asnjë pikë përkshkrimi i ngjarjve nuk i përgjigjet të vërtetës. Vlen të theksohet se autorin Kadrush Sylejmani në punën për librin e kanë ndihmuar në radhë të parë djali i Metushit, Besniku dhe familjarë të tjerë. Përpjekja e Kadrush Sylejmanit është e mirë dhe e ndershme por ai nuk ka ditur të shkruaj histori dhe as nga afër nuk është në nivelin e detyrës.

AVDI IBRAHIMI; KUSH E VRAU LAJMËTARIN, Novelë, VATRA - Prishtinë 2000
Te kjo vepër është me rëndësi të përmendet se redaktor është Rifat Kukaj, autori i Bareshës, (nga disa të cilësuar si "Himni i Kosovës")

Prend Buzhala; Maska e alegorisë (Jusuf Gërvalla: "Rrotull", roman, në librin "Vepra letrare" të këtij autori, botoi "Ora", Prishtinë, 1992), Botuar në "Rilindja", 19 janar 2000, Prishtinë.

Zejnullah Rrahmani; Jusufi, Dukagjini, Pejë, 2000

Hans Joachim Lanksch; Vrasja e Poetit, Rilindja, 17 janar 2001

Bedri Islami; Mesazhet e rikthimit të madh, Epoka e re, f. 20-22 shkurt 2002

Emrush Xhemaili; 20 vjet veprimtari 1982-2002

Bedri Islami; Mos i ndani djemtë, Epoka e re, 27 shkurt 2002

Pandeli Koçi; Poezi që mori bekimin e nënës, Pishtarët e lirisë, nën përgatitjen e Begzat Baliut dhe ndihmës ekonomike të Dardan Novosellës, etj., botoi "Era" Prishtinë, 2002

Ramazan Vozga; Zë origjinal, me botë të gjerë poetike, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut dhe ndihmës ekonomike të Dardan Novosellës, botoi "Era" Prishtinë, 2002

Mehmet Hajrizi; Kadri Zeka e Jusuf Gërvalla njerëzit që kërkuan një zë këmbues për Kosovën, Koha Ditore, 2 mars 2002

Rasim Selmanaj; Vrasja e dytë e heronjve, Botuar te gazeta "24 Orë", 26 shkurt 2002, Prishtinë

Begzat Baliu; Shtypi botëror rreth vrasjes së Vëllezërve Gërvalla e Kadri Zekës, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut, Era Prishtinë, 2002

Xhafer Shatri; Anatomia e një atentati, Zëri, Prishtinë, 2002

Resul Bedo; Nderim Dëshmorëve Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka dhe Bardhosh Gërvalla, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut dhe ndihmës ekonomike të Dardan Novosellës, botoi "Era" Prishtinë, 2002

Lutfi Dërvishi; Bardhosh Gërvalla - Besniku i Kosovës, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut, botoi "Era" Prishtinë, 2002

Lumira Berati; Romani "Rrotull" i Jusuf Gërvallës, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut, botoi "Era" Prishtinë, 2002

Myftar Memia; Publicistika politike e Jusuf Gërvallës,
Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut, botoi "Era" Prishtinë, 2002

Hydajet Hyseni; Therror në themelet e Bashkimit, Zëri, Prishtinë, 21 shkurt 2002 - 2 mars 2002. E ligjëruar edhe si kumtesë në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha")

Pandi Bella; Jusuf Gërvalla si adhurues i tingujve, Pishtarët e lirisë nën përgatitjen e Begzat Baliut, botoi "Era" Prishtinë, 2002

Pishtarët e lirisë (Jusuf Gërvalla, Kadri Zeka, Bardhosh Gërvalla), Editor: Begzat Baliu, Botimin e mundësuan: Dardan S. Novosella, Hamzi Rahimi dhe Sibush Haziri
Shtëpia botuese Era, Prishtinë 2002

Myrvete Dreshaj-Baliu; Jusuf Gërvalla - jeta dhe vepra (tezë e magjistraturës), 2002 (i botuar si libër në Prishtinë më 2010)

Shefqet Jashari-Strofci; PSE U VRANË DHE KUSH MUND TË JENË TË PËRZIER NË VRASJEN U JUSUF GËRVALLËS, BARDHOSH GËRVALLËS DHE TË KARDI ZEKËS, Bota Sot, 26 shkurt - 9 mars 2002

Hydajet Hyseni; Kadri Zeka (Në 50 vjetorin e lindjes së Kadri Zekës- 2003), Rasim Selmanaj, Heroi me Kitarë, f. 111-147

Halit Mehmetaj; Jusuf Gërvalla - Ideatori dhe udhëheqësi i lëvizjes sonë të rezistencës kombëtare, Me rastin e 20-vjetorit të rënies

Nexhmije Hoxha; Jusuf Gërvalla dhe familja e tij në kujtimet e Nexhmije Hoxhës,

Sabri Novosella; Letër e hapur kryetarit të Kosovës, I. Rugova,

Mustafë Xhemaili; Dorëshkrimi nga dheu, 2003 Prishtinë
Parathënia e këtij libri përmban shkrimin "Jusuf Gërvalla mësuesi më i mirë në rrugën time krijuese", ndërsa në faqe 56-57 gjendet një recension i skanuar nga origjinali dhe i rishkruar, ku Jusufi jep mendimin për përmbledhjen e poezive të Mustafë Xhemailit me titull "Sportelet e padukshme"(1978). Libri "Dorëshkrimi nga dheu" përmban edhe poemën në 10 pjesë me titull "Akademi solemne për Jusuf Gërvallën".

Ethem Çeku; Mendimi politik i lëvizjes ilegale në Kosovë 1945-1981, Brezi'81, Prishtinë 2003

Ethem Çeku; Shekulli i ilegales, Brezi'81, Prishtinë 2004

Prof. Dr. Agim Vinca; Kroi si topos poetik, * Nga libri „Kënga e hapur“ (antologji e komentuar), 2005

Dritëro Agolli; Përmes poezisë tek heroi, Parathënie nga libri i Jusuf Gërvallës: Këngët e moshës, Prishtinë 2006

Jusuf Gërvalla; Këngët e moshës, Republika, 2006
Në këtë libër jipet poezi nga Jusufi në vitet e gjimnazit, të shënuara në një fletore. Ajo çka është interesante është se botuesi i këtyre poezive, Sali Kabashi, nuk tregon se prej nga e në çfarë rrethanash u gjet fletorja e Jusufit tek ai.

Xhafer Durmishi; Protesta e Aspirata, Botues: Xhafer Durmishi, Prishtinë 2006

Rasim Selmanaj; Pse bëhet çmimi Jusuf Gërvalla?, Heroi me Kitarë, f.11 (Artikulli është fjalë e lexuar në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin" që u mbajt në Deçan më 17 janar 2007)

Vendimi i Jurisë për çmimin "Jusuf Gërvalla" 2007, Heroi me Kitarë, f. 12-13

Curr Mazrekaj, Shkelzen Tahirsylaj; Deçani, festë gjithëkombëtare në nderim të tre heronjve të janarit 1982, Heroi me kitarë f.14-17

Myrvete Dreshaj-Baliu; Dimensioni kombëtar dhe krijues i Jusuf Gërvallës, Kumtesë e paraqitur në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha")

Agim Vinca; "Heroi me Kitarë", J. G., 25 vjet pas, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha")

Bedri Islami; Merrni nga unë atë që nuk është ndarje; Kumtesë e paraqitur në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha"

Ethem Çeku; Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve shqiptare në Jugosllavi, Heroi me Kitarë, f. 88-96

Faton Mehmetaj; Disa aspekte të lidhjeve të Komitetit të Rrethit të Deçanit me Jusuf Gërvallën në kuadër të LNÇKVSHJ-së, Heroi me Kitarë, f. 158-165, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha"

Fetnete Ramosaj; Ndikimi i personalitetit të Jusuf Gërvallës në luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Heroi me Kitarë, f. 166-170, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha"

Ethem Çeku; Metush Krasniqi e Jusuf Gërvalla, Heroi me Kitarë, f. 179-185

Rushit Ramabaja; Liria në shpirtin e vjershës, Heroi me Kitarë, f. 186-190, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha"

Fehmi Ajvazi; Veprimi ilegal i brezit të Jusuf Gërvallës, Heroi me Kitarë, f. 191-198, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha"

Dr. Emin Kabashi; Krijuesi dhe kohët e tij, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë f. 242-247

Adem Gashi; Harkura e verbit poetik, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f. 264-265

Kadrush Radogoshi; Simbolika e mbijetesës dhe e peizazhit sintetik, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f.278-282

Hasan Ukëhaxhaj; Publicistika e Jusuf Gërvallës në mërgim, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f. 299-303

Ethem Çeku; Jusuf Gërvalla dhe shtypi ilegal i Kosovës, Heroi me Kitarë, f. 308-316

Rafet Rudi; Jusuf Gërvalla - në 25 vjetorin vrasjes së kantautorit, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f. 319-322

Prof. Dr. Isak Shema; Jusuf Gërvalla - student i degës së gjuhës dhe letërsisë shqipe të Universitetit të Prishtinës, Kumtesë e lexuar në sesionin shkencor për Jusuf Gërvallën në Manifestimin "...-Sërish me Jusufin", të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007 nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f.333-335

Agron Y. Gashi; Fjala apo Kitara e Jusuf Gërvallës, Rilindja, 19 janar 2001, Heroi me Kitarë, f.367-372

Nazmi Selmanaj; Për herë të parë; Katër rrëfime ekskluzive për Jusuf Gërvallën Fokusiexpress,

Adem Gashi; Riti i rënies, Kjo poezi e mori shpërblimin e parë në Orën e Madhe, me rastin e 25 vjetorit të vrasjes së Jusuf Gërvallës, Kadri Zekës e Bardhosh Gërvallës të mbajtur në Deçan më 17 janar 2007, të organizuar nga klubi i krijuesve "Rrjedha", Heroi me Kitarë, f.402

Shahbaze Vishaj; Amaneti yt, (Jusuf Gërvallës), Heroi me Kitarë, f.404

Zeqir Gërvalla; Sytë e dëshmorëve, poezi, www.albaniapress.com

Lulet e Gjakut; Jusuf Gërvallës, Heroi me Kitarë, f.405-406

Muharrem Blakaj; Atentat brenda germës "L", roman, Prishtinë 2007

Rasim Selmanaj; Heroi me Kitarë, (Sesion i zgjeruar shkencor) Përmbledhje punimesh të ndryshme të periudhave të ndryshme për Jusuf Gërvallën, Focus, Prishtinë 2007

Ibrahim Kelmendi; Atentatet, Focus, Prishtinë 2007

Ramadan Pllana; Jusuf Gërvalla me shokë - yje të pashuara, www.pashtriku.org, 15 janar 2008

Ibrahim Egriu; Kujtesë nga takimi me heroin, Jusuf Gërvalla

Mehmet Hajrizi; Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Botimet Toena, Tiranë 2008,

Hysen Gega; Asgjë nuk harrohet, (intervistë me B. Elshanin), (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, faqe 342-344)

Sabri Maxhuni-Novosella; 'Bota Sot' nga Sabri Beqiri (Rrëfim në vetën e tretë i Sabri Maxhunit-Novosellës) në 42 vazhdime. Pjesa e fundit është botuar më 17 shtator 2008. Titulli i fejtonit është: "TË (PA) NJOHURAT E ORGANIZIMEVE POLITIKE NË KOSOVË".

Apostol Duka; Vrasje në Shtutgart, Kadri Zeka: 1953-1982, Tiranë, janar 2009

Ramadan Pllana; DËSHMI TË KOHËS PËR ORGANIZATËN PATRIOTIKE LNÇKVSHJ, intervistë dhënë Fadil Shytit dhe Kristina Rasit, 17 mars 2009, e publikuar

në vazhdime në www.albaniapress.com dhe e plotë në www.pashtriku.org

Faridin Tafallari; IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS, www.albaniapress.com, 5 qershor 2009
Në këtë shkrim për herë të parë janë botuar dy letra që Jusuf Gërvalla ia shkruan Kadri Zekës (7 dhjetor 1981 e 15 janar 1982) dhe një dërguar Ibrahim Kelmendit (nëntor 1981).

Donika Gërvalla-Schwarz; "Jusuf Gërvalla ishte gazetar, shkrimtar, veprimtar politik, këngëtar dhe publicist. Tek popullata shqiptare në Kosovë dhe jashtë saj ai është i rrënjosur thellë deri nëpër familje. Popullariteti i tij fillimisht bazohej në prezantimet e tij si këngëtar në radio dhe televizion, si gazetar në "Rilindje" si dhe më pas edhe në jehonën e veprimtarisë së tij politike dhe patriotike në Kosovë dhe Gjermani.

Veprimtaria politike
Shtypja e vazhdueshme e popullatës në Kosovë nga ana e regjimit komunist jugosllav, nga artisti dhe gazetari Jusuf Gërvalla, bëri edhe veprimtarin politik Jusuf Gërvalla. Ai merr pjesë në lëvizjen ilegale, e cila ngjashëm me vendet e tjera të Evropës Lindore që vuanin nga regjimet e tyre diktatoriale përpiqej të mbronte dhe të realizonte të drejtat e popullatës ndaj shtypjes totalitare të regjimeve përkatëse.

Vrasja në Gjermani
Kërcënimet ndaj Jusuf Gërvallës në Gjermani nuk u morën madje seriozisht as nga organet e Atëhershme gjermane: në moshën 36-vjeäare ndaj Jusuf G, vëllait të tij Bardhoshit dhe mikut Kadri Zeka u krye më 17 janar 1982 një atentat në Heilbronn-Untergruppenbach prapa shtëpisë së dy vëllezërve Gërvalla.
Jusuf Gërvalla, i cili ishte i vetmi që nuk vdiq në vendin e ngjarjes do të deklaroj më vonë se nuk pranon të hyj në operacion pa dhënë një deklaratë. Në këtë deklaratë ai akuzon shërbimin e fshehtë jugosllav si autor të këtij atentati.
Jusuf Gërvalla vdes nga plagët e marra më 18 janar 1982 rreth orës 3 të mëngjesit."
Marrë nga http://www.gervalla.org, 2009

Ismet Rashiti; Përjetësia e dëshmorëve, 15 janar 2010, www.pashtriku.org

Ferit Ramadani; Jusuf Gërvalla, zermashqiptare.net, janar 2010

Ferit Ramadani; Jusuf Gërvalla - Prometheu i simbolikës lirike, zemrashqiptare.net, janar 2010

Prof. Dr. Sabile Keçmezi-Basha; Informimi i denjë i çështjes kombëtare në diasporë nëpër mes gazetës "Lajmëtari i Lirisë" (fejton në shtatë vazhdime, www.zemrasshqiptare.net, janar 2010)

Kasam Shaqirvela; Flaka e Yjeve, poezi, www.zemrashqiptare.net, 18 janar 2010

Ismet Rashiti; Rrëfanë lirie, (redaktor Xhafer Shatri, Saime Isufi), Kombi, Prishtinë 2010
Në këtë libër, ajo që është me rëndësi në raport me Jusuf Gërvallën, mbrohet teza se Ibrahim Kelmendi ka qenë shoku më i afërt i Kadri Zekës dhe vëllezërve Gërvalla apo anasjelltas. Me mbrojtjen e kësaj teze duhet ta konsiderojmë se është identifikuar në mënyrë të plotë Xhafer Shatri si njëri nga dy redaktorët e librit. Me sa kam mund të vërej, redaktimi i këtij libri është rasti i parë ku Xhafer Shatri shprehet publikisht me stilografin

e tij, pas botimit-lansimit të librit Atentatet të Ibrahim Kelmendit, më 5 shkurt 2007.

Faridin Tafallari; Me tre yjet e pavdekësisë, Tiranë 2010

Donika Gërvalla-Schwarz; 17 janar 1982, (http://gervallablog.com), 17 janar 2010

Pashtriku: SI U DENUAN SHABAN KLAIQI E ISLAM RAFUNA PËR ZËRIN E KOSOVËS, www.pashtriku.org, janar 2010

Prof. Dr Sabile Keçmezi-Basha; Propaganda e dezinformimi, metoda të organizuara shtetërore jugosllave ndaj shqiptarëve, 29 mars 2010, (www.zemrashqiptare.net)

Sabri Maxhuni – Novosella; REZISTENCA KOSOVARE MES DY ZJARRESH (KUJTIME)
Redaktor: Ekrem Kryeziu, www.sabrinovosellamaxhuni.com, 18 prill 2010
(Është fjala shkrimin Sabri Maxhuni-Novosella 'Bota Sot' nga Sabri Beqiri (Rrëfim në vetën e tretë i Sabri Maxhunit-Novosellës) në 42 vazhdime. Pjesa e fundit është botuar më 17 shtator 2008. Titulli i fejtonit është: "TË (PA) NJOHURAT E ORGANIZIMEVE POLITIKE NË KOSOVË". Tani Kujtimet e tij Sabri Novosella i tregon në vetën e parë, në formë libri, të redaktuara nga Ekrem Kryeziu.)

Në vitin 2010 kemi librin: Nuhi Sylejmani,Vrasja e trefishtë

Përgatitja dhe komentet nga
Xhafer Durmishi (30 shtator 2010, www.albaniapress.com)

6. I Madhi Zot të ruajtë nga Djalli i mallkuar dhe nga djajt-njeri (Letërkëmbim me Shefqet Jasharin)

AKTGJYKIMI I GJYKATËS SË QARKUT NË PRISHTINË
P - nr. 137/80, datë 4 qershor 1980
N Ë E M Ë R T Ë P O P U LL I T

Gjykata e Qarkut në Prishtinë, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtari Isak Nishevci. kryetar, gjyqtari Metush Sadiku dhe gjyqtarët porotë Azem Emini, Maksimoviq Dojqin dhe Qazim Goxhufi, anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Bedrije Kasumi punëtore e kësaj gjykate, në çështjen penale të akuzuarëve:

A K T GJ Y K I M

Të akuzuarët:

Shefqet Jashari, i lindur më 15 maj 1944 në fshatin Strofc, KK Vushtërri, ku edhe jeton, ka kryer shkollën e lartë pedagogjike.

JANË FAJTORË

Dhe atë:

I akuzuari Shefqet Jashari

Sepse për të kryer vepra penale kundër bazës së rregullimit shoqëror socialist vetëqeverisës, të sigurisë së RSFJ, e veçanërisht të cenimit kundër revolucionar të rregullimit shtetëror, të drejtuar në rrëzimin e pushtetit të klasës punëtore e njerëzve punues, shkatërrimin e bashkim-vllaznimit e të barazisë së kombeve e kombësive si dhe të ndërrimit antikushtetutar të rregullimit shtetëror federativ, gjatë vitit 1977 në Prishtinë,

si një ndër organizatorët, në kontaktet e takimet e shpeshta me Sabri Novosellën dhe të akuzuarin Avdyl Lahu, me qëllim të masovizimit të grupit ilegal armiqësor të Kosovës dhe viset tjera të RSFJ ku jetojnë shqiptarët, merren vesh për formimin e organizatës "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës" të cilën edhe e formojnë në vitin 1978 dhe vendosin që të njejtën ta udhëheqë "Komiteti Qendror" e që njëri prej anëtarëve të tij të bëhet i akuzuari Shefqet Jashari, njëherit e aktualizojnë çështjen e përfitimit të anëtarëve të rinj, dhe të shkruarjes së afisheve e parullave me përmbajtje armiqësore, në tremujorshin e parë të vitit 1979 në Prishtinë, pas shumë kontakteve dhe bisedave të mëparshme gjatë viteve 1977 dhe 1978 që i pati me të akuzuarin Ramadan Pllanën e udhëzoi që grupin armiqësor ilegal "Shkëndija e Kuqe" të cilin e kishte formuar gjatë vitit 1978, ta pagëzoi me emrin e ri "Organizata e Lëvizjes së Rinisë nacionalçlirimtare Kosovare". ...

Prandaj gjykata në bazë të neneve të lartcituara si dhe neneve 5, 33, 38, 41 dhe 50 të LPJ si dhe nenit 351 të LPP i

GJ Y K O N

Të akuzuarin Shefqet Jasharin me dënim me burg në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vjetësh.

-1. Letër nga Shefqet Jashari, 31 maj 2009

I nderuar Xhafer, Para një jave ta dërgova një letër, ku në mes tjerash të kërkova adresën për ta dërguar librin që ma ka kthyer Ramadan Pllana. Ndoshta kam gabuar adresën tënde dhe për atë nuk e ke marr letrën time. Pra dërgoma adresën e banesës tënde se do ta postoj menjëherë librin. Duke shpresuar se jeni mirë me shëndet, të përshëndes vëllazërisht. Shefqeti.

-2. Letër nga Shefqet Jashari, 2 korrik 2009

I dashur Xhafer, Me vjen keq që me vonesë të madhe po të lajmërohem, që nga dita kur folëm nëpërmjet telefonit. Unë atë ditë të premtova se do ta dërgoi librin e parë që është shkruar diçka për jetën dhe veprimtarinë e Metush Krasniqit, por nuk pata mundësi ta dërgoi për dy arsye: E para se pa pritur mu dashtë të shkoj në Prishtinë dhe e dyta se për disa orë e kërkova në bibliotekën time jo të sistemuar si duhet, dhe nuk e gjeta. Dje u ktheva ne Zvicër, dhe sot e hapa postën time elektronike. Sot do ta kërkoj edhe një herë librin, e nëse nuk e gjej me siguri ia kam dhënë dikujt. Tash për tash nuk po më kujtohet se a ia kam dhënë dikujt apo jo. Prej një qershorit e kam gëzuar të drejtën e pensionit. Ju përshëndes me selam-paqe. .... Shefqeti.

-3. Letër nga Xhafer Durmishi, 2 korrik 2009

Mirë dita Shefqet,

Urime pensionimin e shpresoj se e gëzon me pushime dhe ndonjë punë që ke dashur t'i kushtosh rëndësi më shumë e për shkak të kohës nuk ke mund.

Do të ishte mirë nëse e gjen librin e Kadrush Sylejmanit për Metushin. Atë libër e kam pas më parë, e kam lexuar dhe kam nxjerrë disa citate. Eshtë libër, për mendimin tim, shumë i dobët. Këtu nuk e ka fajin Kadrush Sylejmani. Qëllimi i tij ka qenë i mirë por rezultati është i dobët. Çështja më duket edhe më delikate pasi me sa më kujtohet në financimin e tij ka kontribuar djali i Metushit. Do të përpiqem ta siguroj në Kosovë nëse nuk mundesh me e gjetë, në mënyrë që ta kem një kopje apo fotokopje. Në punën time,

po që se e siguroj dua vetë t'a bëjë vlerësimin e këtij libri, si anëtarë i organizatës së Metushit, d.m.th. për të mirën dhe për hir të Metushit ai libër meriton një kritikë të ashpër.

Romanin "Krenaria" të Ramadan Hazirit nuk kam mund t'a lexoj ende pasi kisha disa punë tjera paraprake dhe për këtë çast nuk mund të jap ndonjë mendim timin se çfarë rëndësie historike mund të ketë përveç asaj letrare.

Shumë të fala, Xhafer Durmishi

-4. Letër nga Xhafer Durmishi, 16 dhjetor 2009

I dashur Shefqet,

Uroi të jesh mirë Ti dhe gjithë familja.

Herën e kaluar kemi folë për librin e Kadrush Sylejmanit që e ka shkrua për Metushin. Po të tregoj se në ndërkohë i kam siguruar ato citate e fjali që më interesojnë nga ai libër dhe i kam. Nëse e ke një kopje të atij libri që kishe me dashtë me ma dhanë për krejt, (pra mos me ta kthye) kishte me qenë mirë. Nëse nuk ke kopje të veçantë, po e përsëris prapë, sa për lexim në ndërkohë atë libër e lexova dhe citatet që më nevojiten i kam marrë....

Shumë të fala, Xhafer Durmishi

-5. Letër nga Shefqet Jashari, 31 janar 2010

I dashur Xhafer, më vjen mirë që e paske marrë librin, por u gëzova që paske shkëmbyer mendime me Ramadan Pllanën. Edhe unë para ca kohe i kam shkëmbyer ca mendime me Ramadanin gojarisht. Ia kam bërë edhe një vërejtje (një mospajtim) për qëndrimin e tij në lidhje me Organizatën tonë. Do ta dërgoi mendimin tim dhe të Ramadanit. Sa i përket shkrimeve që m'i dërgove për Jusufin para dy javësh, më vjen keq që ende nuk kam mundur t'i hapi. Kushtrimi më ke thënë se nuk e kam një program që mund të m'i hapë ato shkrime. Ai deri tash nuk pati kohë (mirëkuptim) të ma instaloi atë program.

Kisha pasur dëshirë të më njoftosh çka jeni duke punuar. A ke përgatitur ndonjë shkrim për ta botuar. Jam i bindur se kohën e shfrytëzon në maksimum. Kryesorja është që atë që e din, e jam i bindur se shumë dinë, ta vesh në letër. Duke të dëshiruar suksese në punë të përshëndes vëllazërisht. Shefqeti.

-6. Letër nga Shefqet Jashari, 2 shkurt 2010

I dashur Xhafer, sot heret e hapa posten time në internet. U gëzova shumë për gjithë atë material që ma kishe dërguar. Ju lumtë! Kishe bërë një punë të vlefshme duke e njohur opinionin e gjerë me të dhëna të rëndësishme dhe shumë të vlefshme që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Jusufit të juajen dhe shokëve tjerë të Lëvizjes. Edhe vërejtjet që ia keni bërë Ramadan Pllanës përkitazi me shkrimet e tija janë të vlefshme. Ai duhet të jetë shumë mirënjohës sepse janë vërejtje vëllazërore dhe për mendimin tim janë vërejtje me vend. Më vjen keq që tash për tash po e la me kaç, sepse tani është afrua mesi i ditës, koha kur vijnë djemtë për të drekuar e unë më duhet të shkoj deri në shitore për të blerë bukë. Kjo ditë, dy shkurti i vitit 2010, për mua do të jetë e paharrueshme, sepse disa orë i kalova duke lexuar për veprimtarinë e ndritur të shokëve të mi të luftës. Të fala vëllazërore nga Shefqeti

-7. Letër nga Shefqet Jashari, 25 shkurt 2010

Shumë i çmuari Xhafer, Me letrën e fundit më gëzove pa masë. Sa i përket shëndetit nuk guxojmë të ankohemi as unë dhe as ti. Flamat, streset-gajlet e ndryshme, hjekat gjatë kohës së rinisë, lanë pasoja te çdonjëri. Sukseset në punë janë tregues të vërtetë të gjendjes shëndetësore të secilit person. Po ta kam lakminë por për Zotin jo zilinë, për punën që e ke bërë jo vetëm këto dy vitet e fundit, por gjatë tërë jetës tënde.... Vëllazërisht Shefqeti

-8. Letër nga Xhafer Durmishi, 28 shkurt 2010

I dashur Shefqet,

Intervistën Tënde që ia ke dhënë Shefki Osekut në Drita e kam. Por nëse ke ndonjë detal tjetër që do të kishte rëndësi do të përpiqesha ta marrë parasysh. Puna ime që e kam mbledhë, për arsye se e kam njoftë Jusufin personalisht, e ka si personazh kryesor Jusufin. Por unë kam dëshirë që Jusufin ta rrethoj me shokë të mirë pasi qëllimi djallëzor i disave për me ta rrënue historinë është degradimi i shokëve të heroit kryesor, apo xhveshja e heroit prej shokëve dhe vetëm nëse kryhet ky hap atëherë kanë shansa me e degradue heroin kryesor të Lëvizjes tënde e me këtë edhe krejt historinë tënde.

Shumë të fala..., Xhafer Durmishi

-9. Letër nga Xhafer Durmishi, 9 mars 2010

I dashur Shefqet,

Me punën time jam i kënaqur tani për tani pasi një masë e madhe e tekstit po derdhet në letër. Intervistën tënde në Dritën e Shefki Osekut e kam prej gazetës dhe jo në CD. ... Kur të shkosh në Kosovë, kisha pas shumë dëshirë nëse ke kohë, apo me ia dhënë porosinë ndonjë të afërmi e me i sigurua aktakuzat e gjykimit të këtyre dy grupeve. Shumë kisha pasur dëshirë t'i kem për punën që e kam në dorë.

Grupi i Drenasit:

I gjykuar më 17 gusht të vitit 1981:

Bajram Gashi, 15 vjet, Alush Thaçi, 13 vjet, Ismet Sopi, 14 vjet, Çerkin Sopi, 8 vjet, Nuhi Sopi, 7 vjet, Halil Kuliqi, 11 vjet dhe Naim Bujupi 12 vjet.

I gjykuar më 27 maj të vitit 1983, nga Gjykata e Qarkut në Mitrovicë:

Rexhep Mehmeti, me 8 vjet, Shefqet Dibrani, me 5 vjet, Mustafa Mulolli, me 4 vjet dhe Çerkin Peci me 3 vjet burg; Shumë të fala, Xhaferi

-10. Letër nga Shefqet Jashari, 10 mars 2010

I dashur Xhafer Para dy-tri ditësh u ktheva nga Gjermania ku isha në një vizitë te vëllau, vajza ime dhe te një kusheri. Kur u ktheva kompjuterin ma kishin prishur nipat duke luajtur. Sot e bleva një laptop. Kishin mbërri shumë letra e mesazhe. Ju falenderoj shum për dërgimin e shkrimit të Jusufit. Pa e lexuar nuk do të shkoj në shtrat për të fjetur. Zotëri Tafallari mi ka dërguar dy librat e tij. Të parin si dhuratë. Edhe pse atë libër e kam, dhurata e Tafallarit për mua është shumë e vlefshme. Librin e dytë vetëm e kam shfletuar, por nuk e kam lexuar, pasi menjëherë shkova për vizitë në Gjermani. Duke shpresuar se jeni mirë me shëndet ju përshëndes vëllazërisht. Shefqeti

-11. Letër nga Xhafer Durmishi, 3 qershor 2010

Mirë dita Shefqet,

Sot Pashtriku e ka publikua këtë shkrim:

Në 30 vjetorin e gjykimit të anëtarëve të LNÇKVSHJ dhe të daljes në skenë të udhëheqësit të saj Jusuf Gërvalla

JUSUF GËRVALLA:

LUFTA JONË ËSHTË E DREJTË

Sulmi i UDB'së dhe kundërsulmi i Jusuf Gërvallës në shtypin e kohës

-12. Letër nga Shefqet Jashari, 3 qershor 2010

I dashur Xhafer, sot e lexova materialin e dërguar para disa ditësh. Jam për vizitë në Gjermani, dhe për atë shkak disa ditë nuk e kam hapur postën time elektronike. Keni bërë shumë mirë që opinionit ua keni bërë të njohur komentin e Jusuf Gërvallës me rastin e dënimit të grupit të anëtarëve të Lëvizjes gjatë gushtit të vitit 1980. Me nderime vëllazërore Shefqeti

-13. Letër nga Xhafer Durmishi, 30 shtator 2010

Mire dita Shefqet,

Uroi të jesh mirë me të gjitha. Aktgjykimin e Rexhep Mehmetit, Qerkin Pecit dhe shokëve tjerë e kam marrë. Është jashtëzakonisht i rëndësishëm për punën time. Besoj se do ta trajtoj mirë në rrethanat e asaj kohe kur janë zhvilluar ngjarjet. Megjithëse interesi që këto fakte të jenë në disponim të të gjithëve është i përbashkët, prapë se prapë kam dëshirë t'ia përcjellësh falenderimet e mia Rexhepit.

Shkrimi i mëposhtëm është botuar në www.zemrashqiptare.net, më 29 shtator 2010 "Bibliografi aktuale për Jusuf Gërvallën"

Xhafer Durmishi

-14. Letër nga Shefqet Jashari, 15 tetor 2010

Tu ngjat jeta Burrë i Dheut, Xhafer më vjen keq që gjatë verës nuk kam pasur mundësi të komunikoj me ty. Gjatë pushimit të verës isha në Turqi mysafir në Brusë dhe në Stamboll. Tash së voni isha për një javë në Kosovë. Pardje u ktheva dhe tek sonte gjeta kohë ta hapi postën time në Internet. E lexova shkrimin dhe letrën tënde. U gëzova dhe të përgëzoi që në bibliotekën tënde gjenden aq shumë shkrime për Jusuf Gërvallen. Më erdhi mirë që Rexhepi Mehmeti ta paska dërguar aktgjykimin. Do t'i telefonoj dhe do ta falenderoi. Më vjen keq që aktgjykimin e Bajram Gashit me shokë nuk arrijta ta siguroi. E porosita vëllaun tim Shefkiun të intresohej për ta gjetur dikend që e njeh Bajram Gashin apo njërin nga shokët e tij.

Duke shpresuar se kjo verë ka qenë e bereqetshme në punën tënde për përfundimin e projektit madhorë-ndriçimin e punës patriotike të Jusufit me shokë, të përshëndes me nderime të sinqerta.

-15. Letër nga Shefqet Jashari, 15 dhjetor 2010

I dashur Xhafer, e lexova shkrimin tënd "Stilografat e Jusuf Gërvalles" Së pari kërkoj falje që më heret nuk kam pasur mundësi të komunikoj nëpërmjet postës

elektronike. Kësaj vere isha dy herë në Kosovë. ... Më vjen keq që nuk pata mundësi të ndihmoj për ta gjetur dokumentacionin e dënimit të Grupit të Gllogofcit. Shkrimin tënd "Stilografat e Jusuf Gërvalles" e lexova sot me vëmendje dhe më pëlqeu shumë. Keni bërë një punë të mirë duke i demaskuar me fakte vjedhësit e historisë. Në të njejtën kohë keni bërë një punë të shkëlqyer duke na i bërë të qarta raportet e Hysen Geges me Jusufin, Kelmendin, Sylejmanin e të tjerë, raporte këto që kanë rëndësi të madhe për të kuptuar të vërteten e hidhur se në vrasjen e Jusufit, Bardhit dhe Kadriut kanë marrë pjesë edhe "aktivistë"e "patriot" të vetëshpallur, e që ishin dorë e zgjatur e UDB-së jugosllave. Duke ju përgëzuar për punën e madhe që po bëni për ta ndriçuar punën dhe veprën shumë të madhe të Jusuf Gërvallës, ju përshëndesim vëllazërisht. Shefqeti

-16. Letër nga Shefqet Jashari, 20 janar 2011

I dashur Xhafer,

E lexova me vëmendje dhe interesim të veçantë shkrimin tënd: "Flaka e pashuar e Lëvizjes në Intergruppenbach"

Ishte një punim shumë i rëndësishëm për t'i rrëzuar për toke gënjeshtrat dhe shpifjet e vjedhësve (hajnave) të historisë. Të përgëzoj për këtë punë të vlefshme dhe të çmuar për Historinë tonë më të re.

I Madhi Zot të ruajtë nga djalli i mallkuar dhe nga djajt-njeri dhe të dhashtë vullnet, forcë dhe energji për t'i luftuar manipuluesit e shumtë, që po bëjnë përpjekje për shtrembnimin e ngjarjeve të rëndësishme të Historisë tonë kombëtare, si dhe mohimin e personaliteteve që ndikuan fuqishëm në ato ngjarje. Me nderime vëllazërore Shefqeti.

-17. Letër nga Shefqet Jashari, 19 shkurt 2011

I dashur Xhafer, dje e lexova shkrimin tënd "Jusuf Gërvalla dhe demonstratat e vitit 1981 në Evropën Perëndimore". Kelmendi dhe përkrahësit e tij me këtë shkrim dhe shkrimet tuaja të mëparshme u çveshën nga "pendlat e shqiponjes" dhe mbetën ashtu siç janë të veshur me pendlat e korbit dhe sorrës. I demaskove me fakte të shumta si falsifikatorë ordinerë të ngjarjeve dhe Personaliteteve të shquara kombëtare. Të gjorët, nuk janë të vetëdijshëm se një ditë do të përgjigjen për të ligat që ia bënë Kosovës dhe personaliteteve të shquara kombëtare. ... Ty të përgëzoj për punën e çmuar dhe shumë të rëndësishme që po bënë. Me nderime Shefqeti.

-18. Letër nga Shefqet Jashari, 1 mars 2011

I dashur Xhafer,

Shkrimin ''Në kalanë e Jusuf Gërvallës'' e lexova sot. Edhe pse librin e I. Kelmendit nuk e kam lexuar, me shkrimet e juaja e kam të qartë përmbajtjen e tij (përafërsisht), kurse qëllimin e tij ma keni bërë plotësisht të qartë.

Shkrimet e juaja e demaskuan me themel falsifikatorin... dhe njërin ndër kallauzët e mjerë, që i sollën shumë të liga shqiptarëve, shqiptarisë, Kosovës dhe Shqipërisë. Unë e vlerësoj shumë lart punën tënde, me të cilën po i qitni në dritë faktet dhe argumentet e shumta që kanë të bëjnë me veprimtarinë e Jusuf Gërvallës dhe shokëve të tij, dhe njëherësh po i leni me ‘’gishta në gojë’’ falsifikatorët e ngjarjeve të rëndësishme të Historisë tonë më të re.

Të gjitha këto të dhëna dhe fakte që po ua leni të gatshme plejadës së mëvonshme të historianëve tanë, me siguri do t'i përdorin për ta shkruar historinë tonë më të re në mënyrë objektive dhe reale.

...Duke ju dëshiruar shëndet të mirë dhe suksese në punën e mëtutjeshme për ndriçimin e veprimtarisë së Jusuf Gërvallës dhe bashkëpunëtorëve të tij të sinqertë, Ju përshëndes vëllazërisht.

Shefqet Jashari - Strofci

-19. Letër nga Shefqet Jashari, 26 mars 2011

I dashur Xhafer, Dje u ktheva nga Prishtina që isha në një vizitë prej tri javësh, ndërsa sot e lexova komentin tënd në lidhje me Tezat rreth Frontit Popullor për Republikën e Kosovës dhe autorëve të saj. Ishte një koment i shkurtër, shumë i drejt dhe i qëlluar. Të përgëzoj!

Selam, Shefqeti

-20. Letër nga Xhafer Durmishi, 22 dhjetor 2011

I dashur Shefqet,

Librin e Selatinit për Metushin e mora sot. Të falenderoj shumë. Kapitullit të katërt ia lëshova një sy shpejt e shpejt.

UROJ QË VITI I RI 2012 TË JETË VIT I TË MIRAVE DHE SUKSESEVE PËR TY DHE GJITHË TË AFËRMIT TUAJ.

Shumë të fala, Xhaferi

-21. Letër nga Shefqet Jashari, 10 shkurt 2012

I dashur Xhafer, çdo letër e jotja më gëzon, në veçanti kur më njofton se ke shkruar një libër. Të përgëzoj nga zemra për punën e madhe që keni bërë në këto vitet e fundit për ta ndriçuar punën dhe veprën kolosale të Kolosit tonë Jusuf Gërvalla. Me fakte dhe argumente po i hudhë për toke shpifjet e shpifarakve të shumtë që sot po mundohen për të falsifikuar ngjarje historike, duke falsifikuar fakte dhe argumente.

Ju përshëndes sinqerisht, Shefqeti

-22. Letër nga Xhafer Durmishi, 12 shkurt 2012

I dashur Shefqet,

Uroi të jesh mirë me shëndet me punën tënde që e ke përdore. Me këtë rast deshta vetëm sa për informim me të tregua, se në mesin e muajit të kaluar m'u lajmërua Sabriu (Novosella) nga Kosova dhe më tha se shkrimet e mia i kanë pëlqyer, dhe se në Kosovë lexohen me vëmendje. Para një jave m'i dërgoi dy libra. Njëri prej tyre qe "Rezistenca kosovare mes dy zjarresh" të nënshkruara. Mua më vjen shumë mirë që Ju dy themeluesit e gjallë të Lëvizjes, pas 30 vitesh e çmoni punën time. Kjo më inspiron shumë. Po t'i dergoj të bashkangjitura disa faqe nga libri i Sabriut.

Shumë të fala, Xhaferi

-23. Letër nga Shefqet Jashari, 13 shkurt 2012

I dashur Xhafer, më vjen mirë që Sabriu t'u ka paraqitur dhe njëkohësisht e ka thëne një të vërtetë, që hiqkurkushat mundohen ta mohojnë. Është fakt i pa kontestueshëm se ju keni qenë bashkëpunëtori më i ngushtë i Jusufit në Gjermani, për sa kohë që ju keni punuar me te. Po ashtu është fakt se ju pas vrasjes së tij, nga UDB-jugosllave dhe të

ndihmuar nga shqipfolës, bashkëpunëtor të Sigurimit Jugosllav, ju ishit ai që e muarët Lëvizjen për ta drejuar në kushte dhe rrethana tejet të vështira dhe të komplikuara.

Edhe vazhdimi i daljes së Zërit të Kosovës nën mbikëqyrjen dhe redaktimin tënd ishte një sukses i jashtëzakonshëm. Por puna e juaj publicistike duke i publikuar disa libra me fakte të pa kontestueshme për veprën dhe punën e madhe të Jusuf Gërvallës dhe bashkëpunëtorëve të tij mendoj unë është e barabartë me gjithë punën që e keni kryer me Jusuf e Bardhosh Gërvallen dhe shokët e tij të ngushtë, zotëri Tafallarin etj.... Më në fund ju falenderoj për të dhënat që mi ke dërguar dhe njëkohësisht ju përshëndes vëllazërisht. Zoti të ndihmoftë!

-24. Letër nga Shefqet Jashari, 28 prill 2012

I dashur Xhafer, librin Pa taktizime e lexova po sa e mora në posten time elektronike. Edhe ky libër, si librat tjerë të publikuar në faqet e internetit, është një vepër e çmuar dhe shumë e vlefshme për historiografinë tonë, pasi që me fakte dhe argumente po i ndriçoni rrjedhat e ngjarjeve të historisë tonë më të re, veçmas në diasporë. Rrjedha këto që ishin sa heroike dhe madhështore, në saje të veprimtarisë të pakursyer të veprimtarëve të shquar, që punuan me mish e me shpirt për realizimin e synimeve tona madhore kombëtare, po aq ishin edhe të shëmtuara, në saje të veprimtarisë së personave të shëmtuar që u kyçën në ato ngjarje dhe rrjedha historike, për qëllime të tyre personale, klanore dhe karrieriste, me çka e dëmtuan aq rënd Lëvizjen tonë kombëtare, duke e bërë të pa aftë, për t'i pri popullit kur i erdhi "shteku" për t'i pre prangat e robërisë. Duke ju dëshiruar shëndet të plotë dhe suksese të vazhdueshme në ndriçimin e ngjarjeve historike që edhe vet keni marrë pjesë në ato ngjarje, ju përshëndesim dhe ju përgëzojmë edhe për këtë sukses tëndin dhe tonin me librin më të ri "Pa taktizime". Selame të sinqerta nga unë dhe familja ime. Shefqeti

-25. Letër nga Shefqet Jashari, 29 nëntor 2012

I dashur Xhafer, të falenderoj shumë për dërgimin e librit "Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës" . Kam filluar ta lexoj qysh pramë dhe sot jam duke e vazhduar leximin. Është një libër i çmuar për të ardhë deri te e vërteta se kush nga veprimtarët e diasporës shqiptare punoj pa hile dhe me përkushtim në dobi të çështje madhore kombëtare, dhe kush punoj me hile e në dëm veprimtarisë atdhetare që punohej në Atdhe dhe në diasporë. Të përgëzoj për këtë libër siç të kam përgëzuar edhe për librat tjerë. Me të vërtetë po bëni një punë shumë të çmuar. Shëndet dhe punë të mbarë edhe në fusha tjera të jetës. Vëllazërisht Shefqeti

==========

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit
01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012

10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: "*Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror."* (14 janar 1981)

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi-Skenderi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën "Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi". Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtaro-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

==========

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Qershor 2013-Shkurt 2026